cogent
COMMUNICATIONS
Optical Internet

# Akses i Dedikuar Interneti

## Formulari i Porosise se Klientit

**Cogent Albania sh.p.k.**

Blvd. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1,
Kati i 13-te , Tirana 1000
NIPT: L32318026S

*www.cogentco.com*

### Informacioni per Klientin dhe Porosine

| | |
|---|---|
| Emri i Klientit | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Pershkrimi i Klientit | | | Klienti i Rishitjes (Emri) | | |
| Data e Porosise | | | Agjenti Marreveshje | | |
| Data e Kerkuar e Sherbimit | | | Mbarimi i Porosive te | | |

### Informacion mbi Sherbimin

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Lloji i Produktit | | | Monedha e caktuar | | |

**Parametrat e Sherbimit**

| Numri i Porosise | Lloji Porosis | Numri Porosise se Meparshme | Id e Nyjes se Cogent (Node Id) | Sherbimi Interface | Bandwidth CDR Mbps | Kohzgjatja Fillestare Muaj | Menyra e Faturimit | Tarifa Burst (per Mbps) | Tarifa e Instalimit | Tarifa Baze Mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |

**Opsionet** Shenim:Porosite e opsioneve MultiBGP, VLAN, IPv6 dhe LAG kane gjithmone nje Kohezgjatje fillestar prej nje (1) muaj.

| Numri Porosise | Pershkrimi | Komente | | | | | Opsioni Zgjedhur | Tarifa e Instalimit | Tarifa Mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Adresa Publike e IP | Sic pershkruhet ne Pyetesorin IP ose Shtojcen IARM<br>Shenim: [illegible] | | | | | | | |
| | BGP-4 Routing | | Sic shpjegohet ne Pyetesorin BGP<br>Sheni [illegible] | | | | | | |
| | MultiBGP<br>Shenim: LOA(s) e leshuar nga zoteruesit e ASN(s) Sekondare duhet te dorezohet me Formularin | Lloji i Porosise | Porosia e Meparshme | Zoteruesi Sekondar i ASN | ASN Sekondare | Porosia e Portes (ose LAG) | | | |
| | | | | | | | | | |
| | VLAN(s) me roting statik ose BGP<br>Shenim: LOA(s) e leshuar nga zoteruesit e IP(s) Sekondare (nese nuk eshte Klienti) duhet te dorezohen me | Lloji iPorosise | Porosia e Meparshme | ZoteruesiSekondar i IPs | IP Sekondare | Porosia e Portes | | | |
| | | | | | | | | | |
| | IPv6 | Lloji i Porosise | Porosia e Meparshme | Konfigurimi i Portes (ose LAG-bundle) | Porosia | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | Link Aggregation (LAG) (grumbullimi I Link-eve) | Lloji i Porosise | Porosia e Meparshme | Sherbimet e perfshira ne LAG-bundle | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | DNS Hosting | Sic Pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | | | | | |
| | Ofrim i Pershpejtuar | Sic Pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | | | | | |
| | Menyrat e Faturimit (Sic Pershkruhen ne Shtojcen e Produktit) | Metoda Faturimit | | Sherbimi Master | Sherbime te Tjera te Perfshira | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | Cabling (Sic pershkruhet ne Shtojcen e Produktit) | Produkti | Komente | | Porosia e Portes | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | Pajisjet | Sic pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | | | | | |

**Tarifa Totale**

| | Tarifa e Instalimit | Tarifa Mujore |
|---|---|---|
| Tarifa Totale duke perfshire Sherbimet<br>(Shenim: Tarifat Mujore Burst mund te tarifohet vecmas sic percaktohet ne Shtojcen e Produktit bashkengjitur) | | |

Nese Klienti ka zgjedhur te faturohet me nje monedhe tjeter nga monedha e perdorur per Cmimin e Caktuar, Cmimi i Caktuar do te konvertohet ne Monedhen e Faturimit te zgjedhur me lart ne daten e kete Formulari te vleresuar nga Cogent. Duke bere konvertimin ne kete date, Cogent do te perdore kursin e konvertimit te dites paraardhese, sic percaktohet ne www.oanda.com

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Monedha e Faturimit** | | |

**Firma** Klienti: ____________________

cogent COMMUNICATIONS

Optical Internet

## Akses i Dedikuar Interneti

## Formulari i Porosise se Klientit

**Cogent Albania sh.p.k.**

Blvd. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1,
Kati i 13-te , Tirana 1000
NIPT: L32318026S

*www.cogentco.com*

### Informacioni I Shperndarjes se Sherbimit te Klientit

| | |
|---|---|
| Mbajtesi/Emri I Qendres se | |
| Node ID | |
| Adresa e Sherbimit | |
| Ndertesa / Kati | |
| Qyteti, Shteti,Provinca | |
| Kodi Postar | |
| Shteti | |

* Shperndarja e Sherbimit gjithmone kryhet ne Piken e Lidhjes se Cogent sic percaktohet ne Shtojcen e Sherbimit te Produktit bashkengjitur.

| | |
|---|---|
| Emri Kontakti i Shperndarjes | |
| Telefon | |
| Celular | |
| Fax | |
| Email | |

### Informacion Faturimi dhe Kontraktimi I klientit

| | |
|---|---|
| Emri i Shoqerise | |
| Adresa e Faturimit | |
| Ndertesa / Kati | |
| Qyteti, Shteti,Provinca | |
| Kodi Postar | |
| Shteti | |
| Nr. Rregj. te Shoqerise | |
| Numri NIPT | |
| Kerkese per faturim te konsoliduar(nje llogari /fature per porta shumefishe ne te njejtin shtet)* | |

* Kerkesa per Faturim te konsoliduar duhet te rishikohet dhe miratohet nga Cogent.

| | |
|---|---|
| Emri Kontakti i Shperndarjes | |
| Telefon | |
| Celular | |
| Fax | |
| Email | |

### Informacioni Kontakti i Cogent

| | | |
|---|---|---|
| Zyra e Shitjes | Vendndodhja | |
| | Adresa | |
| | Telefon | |
| | Fax | |
| Sigurimi I Sherbimit | | |
| Kujdesi i Klientit | | |

| | | |
|---|---|---|
| Menaxheri I Shitjeve | Emri | |
| | Telefon | |
| | Email | |
| Shitjet | | |
| Faturimi | | |
| Mbarimi | | |

### Dokumentet e Kontraktimit

E gjithe Marreveshja e Abonimit te Klientit (MAK), e lidhur midis Klientit dhe Cogent, eshte e perbere nga dokumente e listuara ketu. Termat me shkronja te medha jane percaktuar ne pjesen Perkufizime ne Kontrate Te gjitha marreveshjet, propozimet, deklaratat paraprake, me shkrim ose me goje, ne lidhje me keto Sherbime, zevendesohen nga kjo MAK. Klienti garanton se dokumentet qe perbejne MAK jane dokumentet dhe formularet qe i jane dhene Klientit nga ana e Cogent dhe Klienti nuk ka bere ndryshime ne to.

(1) Formulari i Porosise

(3) Kushtet dhe Afatet, si bashkelidhur (firmosur nga Klienti) (per kliente ekzistues, nese nuk jane bashkelidhur, mbeten ne fuqi ato aktuale.

(3) Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (MNS) (http://www.cogentco.com/files/ps_interne

(4) Shtojca e Produktit, si bashkelidhur (firmosur nga Klienti)

(5) Cdo Shtojce ose Suplement tjeter, si bashkelidhur (firmosur nga Klienti)

### Shenime

### Nenshkrimet

Duke nenshkruar me poshte, Klienti njeh dhe pranon qe ka lexuar te gjithe MAK dhe eshte dakort ti nenshtrohet parashikimeve te kesaj marreveshjeje .

**per Klientin**

Nenshkrimi ____________________

Emri I printuar ____________________

Titulli ____________________

Data ____________________

**per Cogent Albania sh.p.k.**

Nenshkrimi ____________________

Emri I printuar ____________________

Titulli ____________________

Data ____________________

cogent
COMMUNICATIONS
Optical Internet

**Ethernet Point-to-Point (Layer 2)**

**Formulari I Porosise Se Klientit**

**Cogent Albania sh.p.k.**
Blvd. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 13-te , Tirana 1000
NIPT: L32318026S

www.cogentco.com

### Informacion I Shperndarjes se Sherbimit te Klientit

| | |
|---|---|
| Emri I Shoqerise | 0 |
| Adresa E Shoqerise | Shiko me lart, Informacioni mbi Sherbimin |
| Emri Kontaktit te Shperndarjes | |
| Telefon | |
| Celular | |
| Fax | |
| Email | |

(1) Sherbimi I Shperndarjes behet gjithmone ne Pikan e Lidhjes se Cogent sic percaktohet ne Shtojcen e Produktit bashkelidhur

(2) Ju lutem tregoni emrin e Kontaktit te Shperndarjes te Kordinatorit te sherbime te Klientit. Klienti do ti kerkohet te tregoje gjithashtu emrat e Kontakteve te Shperndarjes per cdo Adrese te vecante Sherbimi

### Infromacion Faturimi dhe Kontraktimi te Klientit

| | | |
|---|---|---|
| Emri I Shoqerise | 0 | |
| Adresa e Faturimit | | |
| Ndertesa / Kati | | |
| Qyteti, Shteti, Provinca | | |
| Kodi Postar | | |
| Shteti | | |
| Nr. Rregj. Te Shoqerise | | |
| Numri NIPT | | |
| Kerkese per faturim te konsoliduar(nje llogari /fature per porta shumefishe ne te njejtin shtet* | | |

* Kerkesa per Faturim te konsoliduar duhet te rishikohet dhe miratohet nga Cogent

| | |
|---|---|
| Emri I Kontaktit te Faturimit | |
| Telefon | |
| Celular | |
| Fax | |
| Email | |

### Informacioni I Kontaktit te Cogent

| | | |
|---|---|---|
| Zyra e Shitjes | Vendndodhja | |
| | Adresa | |
| | Telefon | |
| | Fax | |
| Sigurimi I Sherbimit | | |
| Kujdesi I Klientit | | #N/A |

| | | |
|---|---|---|
| Menaxheri I Shitjeve | Emri | |
| | Telefon | |
| | Email | |
| Shitjet | | |
| Faturimi | | |
| Mbarimi | | |

### Dokumentet e Kontrates

E gjithe Marreveshja e Abonimit te Klientit (MAK), e lidhur midis Klientit dhe Cogent, eshte e perbere nga dokumente e listuara ketu. Termat me shkronja te medha jane percaktuar ne pjesen Perkufizime ne Termat dhe Kushtet. Te gjitha marreveshjet, propozimet, deklaratat paraprake, me shkrim ose me goje, ne lidhje me keto Sherbime, zevendesohen nga kjo MAK. Klienti garanton se dokumentet qe perbejne MAK jane dokumentet dhe formularet qe i jane dhene Klientit nga Cogent dhe Klienti nuk ka bere ndryshime ne to.

(1)Formulari I Porosise

(3) Termat dhe Kushtet , si bashkelidhur (firmosur nga Klienti) (per kliente ekzistues, nese nuk jane bashkelidhur, mbeten ne fuqi ato aktuale.

(3) Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (MNS) (http://www.cogentco.com/files/ps_internet/SLA_on_

(4) Shtojca e Produktit, si bashkelidhur (firmosur nga Klienti)

(5) Cdo Shtojce ose Suplement tjeter, si bashkelidhur (firmosur nga Klienti)

### Shenime

### Nenshkrimet

Duke nenshkruar me poshte, Klienti njeh dhe pranon qe ka lexuar te gjithe MAK dhe eshte dakort ti nenshtrohet parashikimeve te kesaj marreveshjeje .

**per Klientin**

Nenshkrimi ______________________

Emri I printuar ______________________

Titulli ______________________

Data ______________________

**per Cogent Albania sh.p.k.**

Nenshkrimi ______________________

Emri I printuar ______________________

Titulli ______________________

Data ______________________

cogent COMMUNICATIONS

**Optical Internet**

**Ethernet Point-to-Point (Layer 2)**

**Formulari I Porosise se Klientit**

**Cogent Albania sh.p.k.**

Blvd. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 1, Kati i 13-te , Tirana 1000
NIPT: L32318026S

www.cogentco.com

## Informacioni per Klientin dhe Porosine

| | |
|---|---|
| Emri I Klientit | |

| | |
|---|---|
| Pershkrimi I Klientit | |
| Data e Porosise | |
| Data e Kerkuar e Sherbimit | |

| | | |
|---|---|---|
| Klienti I Rishitjes (Emri) | | |
| Agjenti I Marreveshjes (Emri) | | |
| Mbarimi I Porosive te Meparshme (Vonesa) | | |

## Informacion mbi Sherbimin

| | | |
|---|---|---|
| Afati fillestar | | Muaji |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Monedha e caktuar | | |

**Portat (duke perfshire Tail Circuits nese aplikohen)**

| Numri I Porosise | Lloji Porosise | Numri Porosise se Meparshme | Vendndodhja e Sherbimit | | Sherbimi Interface | Gjurma | On/Off-Net | Lloji Portes / Opsioni i mases MTU (shiko Shtojcene Produktit) | Bandwidth CDR | Tarifa e Instalimit | Tarifa mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Id e Nyjes Cogent | Adresa | | | | | Mbps | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |

**Qarqet Virtuale (VC)** Shenim: Qarqet virtuale kane gjithmone nje Afat Fillestar prej nje (1) muaj

| Numri I porosise | Lloji I Porosise | Numri I Porosise se Meparshme | Vendndodhja e Sherbimit A | | | Vendndodhja e Sherbimit Z | | | Tarifa mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Id e Nyjes Cogent | Adresa | Porosia e Portes # | Id e Nyjes Cogent | Adresa | Porosia e Portes # | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |

**Opsionet**

| Numri I porosise | Pershkrimi | Komente | | | Opsioni I Zgjedhur | Tarifa e Instalimit | Tarifa mujore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Cabling (Kabllimi) | | | Sic pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | |
| | Pajisjet | Sic pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | | | |
| | Expedite Delivery Shpemdarja e Pershpejtuar | Sic pershkruhet ne Shtojcen e Produktit | | | | | |

**Tarifa Totale**

| | Tarifa e Instalimit | Tarifa mujore |
|---|---|---|
| Tarifa Totale duke perfshire Sherbimet | 0 | 0 |
| | | 0.00 |

Nese Klienti ka zgjedhur te faturohet me nje monedhe tjeter nga monedha e perdorur per Cmimin e Caktuar, Cmimi i Caktuar do te konvertohet ne Monedhen e Faturimit te zgjedhur me lart ne daten e ketij Formulari te nenshkruar nga Cogent. Duke bere konvertimin ne kete date, Cogent do te perdore kursin e konvertimit te dites paraardhese, sic percaktohet ne www.oanda.com

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Monedha e Faturimit* | | #N/A |

**Firma** Customer: ____________

## SHERBIMET E RRJETIT - TERMAT DHE KUSHTET

1. **SHERBIMET DHE KOHEZGJATJA.**

1.1 Ne baze te Marreveshjes se Abonimit me Klientin (MAK), Cogent do te ofroje Sherbime per Klientin ne baze te tarifave per Sherbimet. Nenshkrimi i Klientit ne Formularin e Porosise ose perdorimi i Sherbimit apo Rrjetit te Cogent perben njohjen e marreveshjes nga ana e Klientit e rregulluar nga MAK. Termat me germa kapitale jane perkufizuar ne fund te kesaj marreveshje.

1.2 Kohezgjatja Fillestare e çdo Sherbimi eshte e percaktuar ne Formularin e Porosise se aplikuar dhe fillon qe nga Data e Sherbimit. Kohezgjatja Fillestare do te filloje ne Daten e Sherbimit. Ne fund te Kohezgjatjes Fillestare, MAK do te rinovoje sherbimin ne Kohezgjatje te Rinovuara te barabarta ne kohezgjatje me Kohezgjatjen Fillestare, pervecse dhe kur marreveshja eshte perfunduar me heret siç parashikohet me poshte.

1.3 Klienti mund te urdheroje Sherbime ose Vendndodhje shtese nepermjet Formularit te Porosise shtese, te cilat do te rregullohen nga kjo MAK. Llogaria e Klientit duhet te jete rrjedhese ne menyre qe te bej ndryshime ne Sherbime apo te urdheroje Sherbime shtese.

2. **TARIFAT PER SHERBIMET DHE FATURIMI.**

2.1 Tarifat e sherbimeve jane percaktuar ne Formularin e Porosise dhe nuk perfshijne Taksat e aplikueshme perveç nese percaktohet ndryshe ne kete marreveshje. Sherbimet e reja ose permiresimet/ zhvendosjet do te cojne ne tarifa/ pagese shtese. Nese nje Sherbim ka ndryshuar vendndodhjen, Cogent do te mbaje Sherbimin ne vendndodhjen e meparshme dhe Klienti do te jete pergjegjes per tarifat e Sherbimit ne kete vendndodhje deri ne kohen kur Klienti te kete perfunduar Sherbimin ne Vendndodhjen e meparshme.

2.2 Tarifat e pavarura nga perdorimit faturohen paraprakisht çdo muaj, tarifat e varura te perdorimit faturohen ne fund te çdo muaji. Te gjitha faturat e Cogent behen te pagueshme brenda 30 diteve nga data e faturimit. Klienti pranon te paguaje te gjitha detyrimet dhe taksat e aplikueshme (te tilla si TVSH) per Sherbimin me marrjen e fatures pa bere ndonje kundershtim, kompesim ose zbritje te fatures. Nje tarife e mevonshme do t'i shtohet balances se Klientit ne vleren me te vogel te mbetur papaguar prej 1.5% ne muaj ose maksimumit te normes ligjore. Cogent mund te ndryshoje specifikimet, kushtet ose tarifat per Sherbimin per çdo Kohezgjatje te Rinovuar te mevonshem duke i dhene Klientit gjashtedhjete (60) dite njoftim paraprakisht. Klienti bie dakort qe detyrimi i tij per te paguar

Tarifat e Sherbimit dhe Taksat sipas kesaj MAK per Sherbimet e kryera perpara perfundimit MAK do te vazhdojne edhe pas perfundimit te MAK.

2.3 Klientet te cilet pretendojne perjashtimin nga taksat duhet ti paraqesin Cogent nje formular perjashtimi te ekzekutuar ne menyren e duhur ose prova te tjera te pranueshme per kete perjashtim nga taksat.

## 3. PERDORMI I SHERBIMIT DHE NDERPRERJA

3.1 Perdorimi nga Klienti i Sherbimeve ose Rrjetit te Cogent mund te behet vetem per qellime te ligjshme dhe duhet te jete ne perputhje me Politiken e Pranueshme te Perdorimit (PPP) te Cogent. Transmetimi i çdo materiali ne kundershtim me ndonje ligj, rregullore ose PPP-ne eshte rreptesisht i ndaluar. Aksesi ne rrjetet e tjera te lidhura me Rrjetin e Cogent duhet te jete ne perputhje me rregullat e ketyre rrjeteve te tjera. Nuk lejohet rishitja e Sherbimeve te Cogent per klientet korporative (te percaktuar si te tille ne formularin e porosise).

3.2 Detyrimet e Cogent dhe mjetet juridike te vecanta te Klientit per deshtimin e Rrjetit apo ndonje Sherbimi te Cogent jane te percaktuara ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (MNS) te Cogent.

## 4. PERFUNDIMI, KUFIZIMI OSE PEZULLIMI

4.1 Para Dates se Sherbimit, Cogent mund te nderprese MAK ne qofte se kjo nuk miratohet nga drejtuesit menaxherial te Cogent (duke perfshire kontrollin e kredive). Cogent gjithashtu mund te kufizoje, te pezulloje ose te perfundoje MAK, perdorimin ose aksesin e cdo Sherbimi nga ana e Klientit, ose te dyja, ne çdo kohe nese (a) Klienti eshte ne shkelje thelbesore te MAK (duke perfshire por jo kufizuar ne PPP) dhe kur sipas gjykimit te vete Cogent, nje kufizim ose pezullim i menjehershem eshte i nevojshem per te mbrojtur Rrjetin e Cogent ose aftesine e Cogent per te ofruar sherbime per kliente te tjere; ose (b) Klienti nuk paguan ndonje fature, brenda tridhjete (30) ditesh nga data e berjes se pagueshme te fatures ose (c) pajisjet e Cogent ne vendndodhjen e Klientit nuk jane te disponueshme, per shkak te nje arsye qe perfshihet brenda sferes se pergjegjesise se Klientit ose te forces madhore (dmth nuk ka asnje mundesi lidhjeje me vendndodhjen e Klientit ose nuk ka akses ne ndertese).

4.2 Secila Pale mund te perfundoje MAK: (a) ne perfundim te Kohezgjatjes Fillestare apo Rinovimit te Kohezgjatjes me kusht qe te njoftoje Palen tjeter te pakten tridhjete (30) dite perpara ne forme te shkruar (ne qofte se Kohezgjatja Fillestare apo Kohezgjatje te Rinovuar eshte i barabarte me nje (1) muaj, atehere njoftimet e dhena gjate Kohezgjatjes Fillestare ose Rinovimit te Kohezgjatjes nuk do te jene efektive deri ne fund te muajit

pasardhes te muajit ne te cilin njoftimi eshte dhene (dmth, njoftimi i marre me 20 Prill hyn ne fuqi ne fund te 31 Maj)); ose (b) perveç kur percaktohet ndryshe ne kete kontrate, gjate nje Kohezgjatja Fillestare ose Kohezgjatje te Rinovuar nese Pala tjeter shkel ndonje term apo kusht thelbesore te kesaj MAK dhe nuk arrin te korrigjoje kete shkelje brenda tridhjete (30) ditesh nga marrja e njoftimit me shkrim.

4.3 Nese Sherbimi perfundon perpara Dates se Sherbimit, Klienti do t'i paguaje Cogent te gjitha Shpenzimet Fillestare per kete Sherbim. Nese Sherbimi perfundon pas dates se Sherbimit, Klienti duhet ti paguaje Cogent (a) Sherbimin deri me daten e nderprerjes, dhe (b) perveçse ne rastin e nderprerjes nga ana e Klientit siç parashikohet ne nenin 4.2 me siper, ose nga ana e Cogent per shkak te deshtimit per te ofruar sherbimin ne vendndodhjen e rene dakord sipas nenit 4.1(c) me siper, Shpenzimet Fillestare (pervec nese jane parapaguar) dhe Koston e Perfundimit. Klienti pranon se Kosto e Perfundimit eshte nje kusht penal vlersues dhe jo gjobor, kjo per shkak se eshte e veshtire te percaktohet demi i Cogent i ardhur nga perfundimi i parakoheshem i nje kerkese per Sherbim. Çdo rilidhje e Sherbimit do te sjelle pagesa shtese rilidhjeje ndaj Klientit dhe ne favor te Cogent, plus normat e aplikueshme ne ate kohe.

4.4 Ne rast mospermbushjeje te detyrimit te pageses nga ana e Klientit sipas MAK, Klienti bie dakort ti paguaje Cogent shpenzimet e arsyeshme, duke perfshire por jo duke u kufizuar ne tarifat ligjore dhe tarifat e mbledhjes se detyrimeve, qe ndermerr Cogent ne permbushje te te drejtave te saj. Te gjitha njoftimet e perfundimit te mardhenies nga ana e Klientit duhet te dergohen veç per secilin Sherbim (duke perfshire edhe perfundimin e sherbimit ne vendndodhje kur Sherbimi kalon ne nje vendndodhje te re) dhe duhet te dergohen ne termseu@cogentco.com.

## 5. MOSNJOHJA E GARANCISE DHE KUFIZIMI I PERGJEGJESISE

5.1 PERVEÇ NESE PERCAKTOHET NDRYSHE SHPREHIMISHT NE KETE KONTRATE, SHERBIMET JANE TE OFRUARA "SIC JANE" DHE AS COGENT AS NDONJE NGA OFRUESIT, LICENSUESIT, ZYRTARET, PUNONJESIT OSE AGJENTET E SAJ NUK JAPIN NDONJE GARANCI OSE KUSHT NE LIDHJE ME SHERBIMET OSE REZULTATET QE DO TE PERFITOHEN NGA PERDORIMI I SHERBIMEVE, SIPAS KESAJ MAK OSE TE TJERA. SHERBIMET JANE BLERE DUKE E NJOHUR KETE KUFIZIM GARANCIE. COGENT SHPREHIMISHT NUK NJEH ASNJE GARANCI APO KUSHT TJERER, TE CDO LLOJI, TE SHPREHURA APO TE NENKUPTUARA, DUKE PERFSHIRE POR PA U KUFIZUAR NE CDO GARANCI APO KUSHT TE TREGTUESHMERISE, TE MOSSHKELJES, TE CILESISE SE KENAQSHME, DHE/ OSE PERSHTATSHMERISE NE PERDORIMIN PER NJE QELLIM TE CAKTUAR NE MAKSIMUMIN E MASES SE LEJUAR NGA LIGJI. COGENT NUK MONITORON, DHE

NUK NJEH ASNJE DETYRIM DHE PERGJEGJESI PER, PERMBAJTJEN E TE GJITHA KOMUNIKIMEVE TE TRANSMETUARA NGA ANA E KLIENTIT OSE TE TJERET, DHE NUK NJEH ASNJE DETYRIM DHE PERGJEGJESI PER PERDORIMIN E PAAUTORIZUAR OSE KEQPERDORIMIN E SHERBIMEVE.

5.2 PA PARAGJYKUAR OSE PA KUFIZUAR TE DREJTAT E COGENT PER TE MARRE PAGESEN PER SHERBIMET E KRYERA, PERGJEGJESIA E PLOTE E COGENT PER TE GJITHA PRETENDIMET E ÇFAREDO NATYRE (DUKE PERFSHIRE PRETENDIMET PER NEGLIZHENCE) QE RRJEDHIN NGA KJO MAK, DHE SIGURIMIN NGA ANA E COGENT TE PAJISJEVE, TRANSMETIMIT, TE DHENAVE, SHERBIMEVE OSE TE APARATURAVE DUKE PERFSHIRE POR JO DUKE U KUFIZUAR NE DEMIN NDAJ TE DRJETAVE NGA PASURI REALE/ PERSONALE, NUK DO TE TEJKALOJE VLEREN ME TE VOGEL TE (A) SHUMES SE PAGUAR NGA KLIENTI PER SHERBIMIN E OFRUAR NE GJASHTE (6) MUAJ PARPARA VEPRIMIT NGA I CILI RRJEDH PRETENDIMI, OSE (B) NJEQIND MIJE EURO (€ 100,000.00) NE TOTAL, POR ME KUSHT QE KUFIZIMET E MESIPERME DO TE ZBATOHEN NË SHKALLEN MAKSIMALE TE LEJUAR SIPAS LIGJEVE NE FUQI DHE NUK DO TE ZBATOHET PER VDEKJE OSE DEMTIM PERSONAL TE SHKAKTUAR NGA COGENT, OSE PER CDO PERGJEGJESI TJETER QE NUK MUND TE PERJASHTOHET OSE KUFIZOHET SIPAS LIGJIT NË FUQI.

5.3 KLIENTI PRANON QE INTERNETI PERBEHET NGA RRJETE TE SHUMTA PJESEMARRESE QE KANE PRONESI TE NDARE NGA NJERI-TJETRI DHE NUK I NENSHTROHEN KONTROLLIT TE COGENT. KLIENTI BIE DAKORT QE COGENT NUK DO TE JETE PERGJEGJESE PER DEMET E PESUARA OSE SHUMAT E PAGUARA KUR SHERBIMI ESHTE BERE PERKOHESISHT OSE NE MENYRE TE PERHERSHME I PADISPONUESHEM PER SHKAK TE KEQFUNKSIONIMIT OSE NDERPRERJES SE SHERBIMIT TE INTERNETIT NGA RRJETI/ET, OSE OFRUESIT E SHERBIMIT TE INTERNETIT QE NUK I NENSHTROHEN KONTROLLIT TE COGENT, OSE PER GABIME NE TRANSMETIM OSE NE MBROJTJEN E INFORMACIONIT TE KLIENTIT TE RUAJTUR NE KETO RRJETE OSE OFRUES SHERBIMESH INTERNETI. COGENT NUK DO TE KETE PERGJEGJESI SIPAS KESAJ KONTRATE PER DEMET E PESUARA APO SHUMAT E PAGUARA PER FAJ TE KLIENTIT OSE NDONJE PALE TE TRETE, OSE NGA NDONJE ELEMENT I DEMSHEM (I TILLE SI VIRUS KOMPJUTERI, DEPERTIMIT, DEMTUES KOMPJUTERI DHE SULMIT PER "MOSPRANIM SHERBIMI"). COGENT NUK ESHTE PERGJEGJESE PER CDO SHKELJE SIGURIE NE RRJETIN E KLIENTIT, PAVARESISHT NESE NDONJE MJET JURIDIK I PARASHIKUAR NE KETE MAK NUK ARRIN QELLIMIN E TIJ KRYESOR. KLIENTI PRANON SE COGENT NUK DO TE JETE PERGJEGJESE PER CDO PERZGJEDHJE OSE MBAJTJE APO VEPRIME OSE MOSVEPRIME TE PALEVE TE TRETA NE LIDHJE ME SHERBIMET, APO TE BEJE NJE PALE TE TRETE TE JETE PERGJEGJESE PER CDO PERZGJEDHJE OSE MBAJTJE

APO VEPRIME OSE MOSVEPRIME NE LIDHJE ME SHERBIMET E COGENT. PA U KUFIZUAR NE SA ME SIPER, KLIENTI PRANON SE COGENT NUK DO TE JETE PERGJEGJESE PER (A) PRETENDIME NGA PALE TE TRETA KUNDER KLIENTIT PER DEME, (B) HUMBJE OSE DEME TE TE DHENAVE TE KLIENTIT OSE TE PALEVE TE TRETA, OSE (C) HUMBJE OSE DEME TE KLIENTIT LIDHUR ME MOSFUNKSIONIMIN E PAJISJEVE APO APLIKACIONEVE TE KLIENTIT ME NDONJE ELEMENT TE SHERBIMIT OSE RRJETIT TE COGENT. KLIENTI PRANON TE NGREJE TE GJITHA PRETENDIMET LIDHUR ME SHERBIMET KUNDEREJT COGENT NE MENYRE TE DRJETPERDREJTE, DHE HEQ DORE NGA ÇDO E DREJTE PER KERKIMIN E DEMEVE (DREJTPERDREJT OSE ME ANE TE DEMSHPERBLIMIT) NE LIDHJE ME SHERBIMET DUKE PRETENDUAR KUNDREJT APO NEPERMJET NJE PALE TE TRETE NE KETE MAK.

5.4 AS COGENT DHE AS NDONJE SUBJEKT TJETER I PERFSHIRE NE KRIJIMIN, PRODHIMIN, SHPERNDARJEN (DUKE PERFSHIRE PEZULLIMIN OSE NDERPRERJEN E SHERBIMEVE) OSE MBESHTETJEN E SHERBIMEVE NUK DO TE JENE PERGJEGJES KUNDREJT CDO KLIENTI, PERFAQESUESI, OSE CDO PALE TE TRETE PER CDO DEM TE TERTHORTE, TE RASTESISHEM, TE VEÇANTE, DHE NDESHKUES QE LIND SI PASOJE E SHERBIMEVE APO NGA PAAFTESIA PER TE PERDORUR SHERBIMET, DUKE PERFSHIRE POR PA U KUFIZUAR NE TE ARDHURAT E HUMBURA, FITIMET E HUMBURA, HUMBJA NE TEKNOLOGJI, TE DREJTAT OSE SHERBIMET, EDHE NESE ESHTE PARALAJMERUAR MUNDESIA E DEMEVE TE TILLA, NGA KONTRATA APO DEME JASHTEKONTRAKORE (DUKE PERFSHIRE NEGLIZHENCEN, PERGJEGJESINE PA FAJ OSE TE TJERA).

## 6. **<u>DEMSHPERBLIMI</u>**

6.1 Klienti do te demshperbleje, mbroje dhe do ta mbaje te pademtuar COGENT, drejtuesit, zyrtaret, punonjesit, shoqerite e lidhura, agjentet dhe nenkontraktoret e saj nga dhe kundrejt çdo pretendimi, padie, veprimi dhe procedure kundrejt çdo dhe te gjithe paleve te treta, dhe per mbulimin e cdo humbje, deri ne masen qe keto humbje lindin (a) si rezultat i mosrespektimit te detyrimeve nga ana e Klientit ne perputhje me MAK, (b) nga çdo dhe te gjitha pretendimet nga cdo klient i Klientit ose cdo pale e trete konsumatore ne lidhje me nje Sherbim (duke perfshire por pa u kufizuar ne, çdo pretendim te lidhur me permbajtjen e transmetuar duke perdorur nje sherbim te caktuar apo shkelje te legjislacionit te mbrojtjes se te dhenave), pa marre parasysh formen e veprimit, me kusht qe Klienti nuk do te kete asnje detyrim te demshprebleje dhe te mbroje COGENT kundrejt pretendimeve per demshpreblim lidhur me demtimet fizike ose vdekje te shkaktuara nga neglizhenca e tepruar apo veprimet me paramendim te COGENT, ose (c) nga cdo pretendim i shkeljes

se te drejtave te autorit dhe te gjitha llojet e pretendimeve te pronesise intelektuale, pretendimet per shpifje, pretendimet e publikimeve te turpshme, pahijsheme, fyese, raciste, te dhunshme ne menyre te paarsyshme, kercenuese, frikesuese ose materiale ngacmuese, dhe nga pretendimet e shkeljes se legjislacionit te mbrojtjes se te dhenave personale, deri ne masen qe keto Humbje rrjedhin nga (i) permbajtja e çdo informacioni e transmetuara nga Klienti, cdo klient i Klientit ose perdorues fundor i autorizuar (ii) perdorimi dhe/ose publikimi i çdo dhe te gjitha komunikimeve ose informacioneve te transmetuara nga Klienti, cdo klient i Klientit ose perdorues fundor i autorizuar ose (iii) perdorimi i Sherbimit(eve) nga Klienti ne çdo menyre qe eshte jo-konsistente me kushtet e kesaj MAK, duke perfshire por pa u kufizuar ne PPP-ne.

## 7 DISPOZITA SHTESE

7.1 Me perjashtim te rasteve te detyrimeve qe duhen paguar nga ana e Klientit, asnje pale nuk do te kete asnje pretendim ose te drejte kundrejt Pales tjeter per çdo mospermbushje te detyrimeve per shkak te Forces Madhore.

7.2. Asnje Pale nuk eshte agjente ose perfaqesuese ligjore e Pales tjeter, dhe kjo MAK nuk krijon asnje partneritet, sipermarrje te perbashket ose marredhenie mirebesimi ndermjet COGENT dhe Klientit. Asnjera pale nuk eshte e autorizuar per te rene dakord per apo te detyroje Palen tjeter ne cfaredolloj forme. Kjo MAK nuk jep asnje te drejte, mjet juridik, apo pretendim te çdo lloji mbi cdo pale te trete, duke perfshire pa u kufizuar ne abonentet dhe perdoruesit fundor te Klientit.

7.3 Njoftimet, ne rastet kur kerkohen, duhet te dergohen me shkrim me e-mail, poste apo poste e klasit te pare (poste e parapaguar) kontakteve te duhuara te listuara ne Formularin e Porosise, dhe njoftimet konsiderohen te kryera ne menyren e duhur kur jane derguar ne ate adrese; me kusht qe Njoftimi per Perfundim te marredhenieve per COGENT duhet te dergohet ne perputhje me nenin 4.4 me lart. Ne rast te nje emergjence, COGENT mund te jete ne gjendje te ofroje vetem nje njoftim paraprak verbal i shoqeruar me pas me nje njoftim me shkrim. Klienti eshte pergjegjes per saktesine e informacionit te tij te dhene ne Formularin e Porosise, duke perfshire edhe pikat e kontaktit.

7.4 Klienti nuk mund te transferoje te drejtat qe rrjedhin nga kjo MAK, pa miratimin paraprak me shkrim te COGENT, miratim i cili nuk duhet te mbahet pa arsye. Çdo transferim te drejtash pa miratimin paraprak me shkrim te COGENT eshte i pavlefshme.

7.5 Pa u kufizuar ne ndonje detyrim tjeter i cili shprehimisht le ne fuqi MAK edhe mbas kalimit te afatit ose perfundimit paraprak te MAK, kalimi i afatit ose perfundimit paraprak i MAK do te shkarkoje te dyja Palet nga çdo detyrim i metejshme percaktuar ne kete marreveshje, me perjashtim te rasteve qe tregohen ne nenet 2, 3 , 4.3, 4.4, dhe 5 deri ne 7, detyrime te cilat do te mbeten ne fuqi edhe mbas çdo kalimi afati ose perfundimit te kohezgjatjes.

7.6 Rrjeti i COGENT zoterohet nga COGENT, ose licensuesit e saj, dhe eshte i mbrojtur nga e drejta e autorit dhe ligjet e tjera te pronesise intelektuale. Klienti pranon qe e drejta per pronesine dhe Sherbimet, ne çdo forme, ne çdo kohe dhe ne çdo rast do te jete e drejte eskluzive e COGENT. Klienti do te kete te drejta vetem ne lidhje me Sherbimet siç eshte percaktuar specifikisht ne kete marreveshje.

7.7 Kjo MAK dhe cdo marreveshje e tjeter e shkruar, si edhe dokumentet dhe instrumentet qe mund te zbatohen ne lidhje me kete marreveshje, jane marreveshja perfundimtare dhe e plote e lidhur ndermjet Klientit dhe COGENT dhe zevendeson te gjitha negociatat ekzistuese dhe paraprake dhe premtimet dhe marreveshjet me goje, te cilat jane perthithur dhe integruar ne kete marreveshje MAK.

7.8 Kjo marreveshje MAK dhe çdo Shtojce e hartuar ne lidhje me kete marreveshje mund te ekzekutohen ne nje ose me shume kopje te njejta, te cilat te gjitha se bashku perbejne nje dhe te njejtin instrument.

# PERKUFIZIMET

| | |
|---|---|
| PPP | Do te nenkuptoje Politiken e Pranueshme te Perdorimit te COGENT (aktualisht e disponueshme ne faqen zyrtare te internetit www.cogentco.com/us/AcceptableUsePolicy.php). Cogent rezervon te drejten te ndryshoje PPP-ne e saj ne çdo kohe, e cila hyn ne fuqi pas publikimit ne faqen e zyrtare te internetit te COGENT. |
| COGENT | Do te nenkuptoje filialin apo degen e Shoqerise COGENT Communications, Inc e identifikuar ne Formularin e Porosise te aplikueshem. |
| Rrjeti i COGENT | Do te nenkuptoje Rrjetin e transmetimit te te dhenave dhe telekomunikacionit dhe komponenteve te rrjetit te zoteruar, operuar apo kontrolluar nga COGENT, duke perfshire fibrat kombetare backbone, rrjetet e fibrave urbane, çdo pajisje te lidhur me keto fibra, software, te dhena dhe njohuri te perdorur nga COGENT per te ofruar Sherbimet. Ne rastet kur Cogent ofron sherbime per nje ndertese me pajisjet e veta, Rrjeti i Cogent i perfshin edhe keto pajisje. Rrjeti i COGENT nuk perfshin pajisjet ne ambjentet e klientit, rrjetet e telefonise se klientit, dhe çdo rrjet ose pajisje te rrjetit qe nuk operohet dhe kontrollohet nga COGENT. |
| MAK | Do te nenkuptoje te gjithe Marreveshjen e Abonimit me Klientin te lidhur ndermjet Klientit dhe COGENT per ofrimin e Sherbimit, e perbere nga Formulari i Porosise, Termat dhe Kushtet, MNS dhe çdo Shtojce apo Amendim i bashkangjitur. |
| Klienti | Do te nenkuptoje klientin e identifikuar ne Formularin e Porosise te aplikueshem. |
| Pajisje | Do te nenkuptoje pajisjen e Klientit, nese ka ndonje. |
| Force Madhore | Do te nenkuptoje shkaqet qe rrjedhin jashte kontrollit te Paleve, duke perfshire por pa u kufizuar ne: aktet e zotit, zjarre, shperthime, vandalizem, |

demtime te kabllorit, stuhi, permbytje apo dukuri te tjera te ngjashme; cdo ligj, urdher, rregullore, udhezim, veprim apo kerkese e cdo qeverie, duke perfshire qeverine qendrore, komunat, bashkite dhe qeverite vendore duke pretenduar juridiksion mbi nje Pale ose Sherbim, ose te çdo departamenti, agjensie, komisioni, zyre, korporate, ose cdo lloj instrumenti tjeter i ketyre institucioneve qeverisese; ose te çdo autoriteti civil apo ushtarak; emergjencat kombetare, mosdisponueshmeria e materialeve ose te te drejtave te kalimit, kryengritjet, trazirat, aktet terroriste, lufta (te deklaruara/ padeklaruara), apo greva, gjendja e jashtezakonshme, ndalime te punes, veshtiresi te tjera pune, deshtime te furnizuesit te sherbimeve, mungesa, shkelje apo vonesa.

| | |
|---|---|
| Shpenzimet Fillestare | Do te nenkuptoje tarifen me te madhe midis (a) tarifave te instalimit (nese nuk eshte paguar) ose (b) te gjitha shpenzimet dhe pagesat e ngarkuara kundrejt COGENT te kryera ne emer te Klienteve per ofrimin e Sherbimit duke perfshire por pa u kufizuar ne pagesat vendore local loop, pagesa per nderlidhjen, dhe tarifat e instalimeve. |
| Kohezgjatja Fillestare | Do te nenkuptoje kohezgjatjen fillestare te Sherbimit sic eshte percaktuar ne Formularin e Porosise. |
| Humbjet | Do te nenkuptojne shpenzimet, tarifat, pergjegjesite, humbjet, demet ose penalitetet, duke perfshire dhe tarifat e arsyeshme per sherbimin ligjor. |
| Formulari i Porosise | Do te nenkuptoje formularin e porosise te cilit i bashkengjitete edhe keto Terma dhe Kushte, qe identifikon sherbimin specifik qe do te ofrohet. |
| Pale ose Palet | Do te nenkuptojne COGENT dhe/ose Klienti |
| Kohezgjatja e Rinovuar | Do te nenkuptoje zgjatjen e metejshme te ofrimit te Sherbimit me kohezgjatje te njejte mbas perfundimit te Kohezgjatjes Fillestare. |

| | |
|---|---|
| Sherbim | Do te nenkuptoje sherbimin e ofruar nga COGENT ne perputhje me Marreveshjen e Abonimit te Klientit. |
| Data e Sherbimit | Do te nenkuptoje daten me te hereshme ne te cilen (a) COGENT gjykon se Sherbimi eshte ne dispozicion per perdorim nga Klienti edhe ne rastet kur Cogent percakton piken e lidhjes apo piken e fundit te testimit vene ne dispozicion ose (b) Klienti perdor me pare sherbimin ose Rrjetin e COGENT. Sherbime te ofruara nga COGENT ne perputhje me Marreveshjen e Abonimit te Klientit. |
| MNS | Do te nenkuptoje Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit te postuar nga COGENT (aktualisht e disponueshme ne faqen zyrtare ne internet: www.cogentco.com/files/ps_internet/SLA_on_internet.pdf) per Sherbime specifike te Klientit. COGENT rezervon te drejten per te ndryshuar Sherbimin e MNS ne çdo kohe, e cila do te hyje ne fuqi pas publikimit ne faqen zyrtare te internetit te COGENT. |
| Takse ose Taksat | Do te nenkuptojne te gjitha taksat e pagueshme ne çdo juridiksion, duke perfshire pa kufizuar te gjitha taksat per: shitjet, perdorimin, akcizen, te hyrat bruto, vleren e shtuar, te ardhurat, transferimet, ekskluzivitetin, telekomunikacionin, pronen (per klientet e bashke-vendodhur), konsumit, ose taksa te tjera, tarifa, detyrime ose shpenzime (sido te percaktuara) te cilat jane te vendosura mbi ose ne baze te dispozites se shitjes ose perdorimit te Sherbimit(eve), duke perfshire edhe taksat te tilla te vendosura direkt per COGENT ose per te cilat COGENT i lejohet te faturoje klientin ne lidhje me ecurine e aktivitetit te COGENT ne perputhje me MAK. Tatimet nuk perfshijne taksat mbi te fitimet e COGENT. |
| Kostot e Perfundimit | Do te nenkuptojne nje pagese te vetme te barabarte me pagesen e anullimit dhe vleren totale te pageses se mbetur te Sherbimit te zbatueshem pergjate Kohezgjatjes Fillestare dhe Kohezgjatjes se Rinovuar, sic zbatohet. |
| Kushtet | Do te nenkuptojne kushtet dhe termat qe zbatohen kur Cogent ofron Sherbimin per Klientin. |

## SHERBIMET E RRJETIT - SHTOJCA PER REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kjo shtojce (Shtojce) ndryshon Kontraten e Pajtimit me Klientin (KPK) e lidhur ndermjet Klientit dhe Cogent per Sherbimet e percaktuara ne KPK. Perveç nese percaktohet ndryshe ketu, termat me shkronja te medha ose fjalet e percaktuara ne KPK kane te njejtin kuptim edhe ne kete Shtojce. Ne rast te nje konflikti ndermjet formave, radha e prioritetit do te jete si ne vijim: Se pari, Formulari i Porosise, Se dyti, kjo Shtojce, Se treti Termat dhe Kushtet, se katerti, Shtojca e Produktit te Sherbimit, dhe se pesti, Marreveshja e Nivelit te Sherbimit (MNS).

1. KPK do te qeveriset dhe interpretohet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise, pa marre parasysh parimet lidhur me zgjedhjen e ligjit qeverises.

2. Klienti, nese ka te tilla, mund te beje ankesat, kerkesa dhe sugjerime me shkrim ne nje nga format e percaktuara nga Cogent ne KPK dhe te publikuar ne faqen elektronike te Cogent, te cilat mund te dergohen tek Cogent:

   a) me poste;
   b) faks;
   c) online.

   Cogent gjithashtu do te pranoje ankesat, kerkesat dhe sugjerimet e Klientit ne pikat e shitjes te Cogent ose nepermjet perfaqsuesve te Cogent ne vendet ku ofrohet sherbimi.

3. Klienti duhet te paraqesi nje ankese tek Cogent:

   a) brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga marrja e fatures per sherbimin e ofruar, nese ankesa i referohet shumes se faturuar per sherbimin e ofruar; ose

   b) brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga ofrimi i sherbimit, nese ankesa i referohet cilesise se sherbimit te ofruar.

4. Cogent do te marre ne konsiderate ankesat, kerkesat dhe propozimet e plotesuara, duke paraqitur nje raport per to dhe duke dhene nje pergjigje me shkrim ne nje nga format e percaktuara ne KPK dhe te publikuar ne faqen elektronike te Cogent, brenda 15 (pesembedhjete) diteve kalendarike te marrjes se tyre.

   Pergjigjia e Cogent i dergohet Klientit me shkrim nepermjet:

   a) Postes;
   b) Faksit; ose
   c) Online.

5. Nese Klienti nuk bie dakort me pergjigjen me shkrim te Cogent atehere Klienti ka te drejte te nis nje proçedure per zgjidhjen e mosmarreveshjes duke ndjekur ne menyre kronologjike hapat e meposhteme:

   a) Duke iu drejtuar AKEP-it sipas rregullave te percaktuara Rregulloren Nr.29 date 29.5.2013 "Per zgjidhjen e mosmarreveshjeve ndermjet pajtimtareve dhe sipermarresve te komunikimeve elektronike"; dhe

   b) Gjykates kompetente Shqiptare, dhe konkretisht gjykates ku Klienti ka seline e tij.

6. Palet njohin dhe pranojne qe konfidencialiteti i te dhenave eshte subjek i mbrojtjes se ofruar nga ligjet e Republikes se Shqiperise.

7. Pervec se nese Klienti zgjedh Anglishten si gjuhen e komunikimit, cdo komunikim midis Paleve lidhur me ofrimin e sherbimeve do te behet ne gjuhen Shqipe.

**Cogent Albania SH.P.K.**
Blvd. Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake,
Kulla 1, Kati 13, Tirana
NIPT: L32318026S

Pranuar dhe rene dakort midis:

| | |
|---|---|
| | COGENT ALBANIA SH.P.K. |
| Klienti: ____________________ | |
| Nga: ____________________ | Nga: ____________________ |
| Titulli: ____________________ | Titulli: ____________________ |
| Date: ____________________ | Date: ____________________ |

## SHTOJCA E PRODUKTIT TE SHERBIMIT – ETHERNET POINT-TO-POINT

Kjo Shtojce e Produktit te Sherbimit (Shtojca) ndryshon Marreveshjen e Abonimit te Klientit (MAK) te lidhur ndermjet Klientit dhe COGENT per Sherbimet e percaktuara ne MAK. Perveçse nese percaktohet ndryshe ne kete Shtojce, termat me germa kapitale ose te perkufizuara ne MAK do te kene te njejtin kuptim edhe ne kete Shtojce. Ne rast te ndonje mosperputhshmerie ndermjet ketyre marreveshjeve, prevalenca do te jete si ne vijim: E para, Formulari i Porosise, E dyta, kjo Shtojce, E treta, Termat dhe Kushtet dhe e Katerta, Marreveshja per Nivelin e Sherbimitm (MNS).

### 1. Sherbimi dhe Opsionet

Ne perputhje me qellimin e Sherbimit te Ethernet Point-to-Point, Cogent transmeton paketen Ethernet midis Rrjetit te Cogent dhe rrjeteve te tjera te lidhura me Klientet e tij, me ane te lidhjeve te dedikuara VLAN (Qarqeve Virtuale ose VC) te ngritura midis portave Ethernet. Sherbimi Ethernet Point-to-Point i Cogent perfshin nje madhesi standarte maksimale Ethernet MTU prej 1,500 bytes dhe nuk perfshin sherbimin multicast.

Sherbimi Ethernet Point-to-Point i Cogent ofrohet ne baze te nje "tarife fikse" per cdo porte. Ne Formularin e Porosise eshte rene dakord per nje Bandwidth CDR (Norma e Angazhimit te te Dhenave) per çdo porte dhe perfaqeson Bandwidth-in maksimal qe mund te kryhet ne kete porte, pavaresisht nga CDR-ja e portave te tjera me te cilat kjo porte eshte e lidhur virtualisht me ane te nje VC. Ne Vendndodhjet e Sherbimit On-Net, CDR ofrohet ne shtesa prej 100 Mbps. Ne Vendndodhjet e Sherbimit te Klientit Off-Net, CDR mund te ofrohet ne shtesa me te vogla, ne varesi te lidhjes local loop te paleve te treta te zgjedhura per te bere lidhjen me Vendndodhjen e Klientit.

Ne varesi te disponueshmerise se tij, Klienti mund te zgjedhe nje ose me shume opsione te lidhura me Sherbime te tilla si ato te listuara ne Formularin e Porosise, ku ne kete rast Klienti bie dakord per te paguar tarifat perkatese sic percaktohet ne Formularin e Porosise.

*Lloji i Portes:* Cogent mund te ofroje Akses (Untagged), Trunked (Tagged) ose porta te tipit QinQ ne disa lloje te caktuara sherbimesh Ethernet Point-to-Point.

*Masa MTU:* Cogent mund te ofroje paketa te medha (jumbo frames) ne disa sherbime te caktuara Ethernet Point-to-Point deri ne 1,546 byte ne portat Fast-Ethernet dhe 2,000 byte ne portat Gig-Ethernet.

*Ofrimi i Pershpejtuar:* Garancia e instalimit te COGENT eshte rigorozisht e kufizuar nga garancia e instalimit e parashikuar ne MNS. Megjithate, Klienti mund te kerkoje ne Formularin e Porosise, nje ofrim te pershpejtuar te Sherbimit. COGENT do te ndermarre perpjekje te arsyeshme tregtare per te mundesuar kerkesen e Klientit; me kusht, qe COGENT nuk do te garantoje permbushjen e nje kerkese te tille (dhe çdo garanci e tille e dhene me goje ose me shkrim konsiderohet nepermjet kesaj marreveshje e refuzuar) si dhe COGENT nuk do garantoje qe Sherbimi do te ofrohet ne nje date te caktuar, si p.sh. Data e Kerkuar e Sherbimit e percaktuar ne Formularin e Porosise.

*Sherbimet Multi-Site:* Porosite per sherbime Multi-site jane porosi ku portat Ethernet ne me shume se dy (2) Vendndodhjeje Sherbimi jane porositur ne te njejten kohe. Per te gjitha porosite Multi-site, Cogent nuk garanton (dhe çdo garanci e tille e dhene me goje ose me shkrim konsiderohet nepremjet kesaj marreveshje e refuzuar) qe te gjitha portat e porositura do te instalohen ne te njejten date, qe portat do te instalohen brenda nje periudhe te caktuar nga njera tjetra, ose qe faturimi per Sherbimet e kerkuara do te shtyhet derisa te gjitha portat te instalohen. Cogent do te instaloje portat kur ato te behen te disponueshme dhe do te filloje faturimin per Sherbimet e instaluara ne momentin qe nje minimum prej dy (2) portash qe synohen te lidhen nga nje VC te jene te instaluara. Nese ne Vendndodhjet shtese te Klientit do te instalohen porta shtese, faturimi per keto porta do te filloje ne momentin e instalimit. Sherbimet Multi-site, te cilat perfshijne portat On-Net dhe Off-Net, mund kene vonesa te konsiderueshme ne kohe midis instalimit te portave On-Net dhe atyre Off-Net; sic permendet me lart, faturimi per Sherbimin do te filloje ne momentin kur te jene instaluar nje minimum prej dy (2) portash.

**2. Detyrimi i Klientit per Bashkepunim**

Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te bashkepunoje me Cogent ne procesin e instalimit, proces i cili perfshin permbushje e sakte te nje Formulari Porosie qe permban informacion te detajuar per lidhjen (demarcation) dhe listimin e kontakteve te tjera ne vendndodhje, dhe te pyetesoreve te nevojshem teknik (Pyetesori IP, Pyetesori BGP,etj) te dhene nga Cogent. Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te jene fizikisht te pranishem ne momentin e instalimit. Gjate instalimit dhe ne cdo kohe tjeter, Klienti do te lejoje aksesin dhe nese eshte e nevojshme te siguroje shoqerimin, per Cogent ose perfaqesuesit e saj, personelin e nevojshem per te kryer instalimin dhe mirembajtjen e Sherbimit, ne kasen(at) telefonike te percaktura ne ndertese ose dhomat e telekomunikacionit ose ne ambjentet e Klientit me qellim kontrollin, instalimin, funksionimin dhe mirembajtjen e Sherbimit, pas nje marreveshje paraprake midis paleve. Mosbashkepunimi i Klientit do te shkarkoje Cogent nga detyrimet e saj ne lidhje me Garancine e Instalimit qe ben pjese ne MNS, por nuk do te nderprese Daten e Sherbimit ose daten e fillimit te faturimit.
Ne rastin e problemeve teknike te lidhura me Sherbimin, Klienti do te siguroje qe inxhinieret e sherbimit te Cogent ose perfaqesuesit e tij te kene nje akses te pakufizuar ne kasen(at) telefonike te caktura ne ndertese ose dhomave te telekomunikacionit ose ne pajisjet e ndodhura ne ambjentet e Klientit. Mossigurimi i aksesit nga ana e Klientit, do te shkarkoje Cogent nga detyrimet e tij ne perputhje me Disponueshmerine e Rrjetit, si pjese e MNS.

**3. Pika e Lidhjes**

*Ne Qendren e te dhenave te Cogent*: Nese ofrimi i Sherbimit kryhet brenda nje qendre te dhenash te Cogent, shoqeria Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje pike lidhjeje qe ndodhet ne pajisjet Cogent. Cogent do te siguroje, ruaje dhe operoje lidhjen e nevojshme ("Cross-Connect") per Klientin per t'u lidhur me sherbimin e Cogent ne piken e caktuar te lidhjes. Cogent do te siguroje kete lidhje Cross-Connect kundrejt tarifave sic tregohet ne Formularin e Porosise.

*Ne nje qender te dhenash te nje pale te trete*: Nese ofrimi i Sherbimit kryhet brenda nje qendre te dhenash te nje pale te trete (psh. qe nuk eshte ne zoterim dhe/ose operim nga Cogent), shoqeria Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje Pike Lidhjeje te vendosur ne pajisjet e Cogent. Pervec nese eshte rene dakort ndryshe, Klienti me shpenzimet e veta do te siguroje, ruaj dhe operoj lidhjen e nevojshme ("Cross-Connect") per t'u

lidhur sherbimin e Cogent me piken e caktuar te lidhjes. Nese Klienti dhe Cogent bien dakort qe Cogent do te ofroje kete lidhje, atehere Cogent do te ofroj kete lidhje perkundrejt tarifave ashtu sic tregohet ne Formularin e Porosise.

*Ne nje ndertese te nje shoqerie On-Net:* Nese ofrimi i Sherbimit kryhet On-Net brenda nje ndertese te nje shoqerie, Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje pike lidhjeje te pozicionuar ne pajisjet e Cogent ne ambjentet e Klientit. Cogent do te siguroje, mbaje dhe operoje lidhjen e nevojshme ("Riser") ndermjet hyrjes ne ndertese dhe pikes se caktuar te lidhjes.

*Ne nje Vendndodhje te Klientit Off-Net*: Sherbimet Off-Net do te ofrohen ne Vendndodhjen e Klientit sic tregohet ne Formularin e Porosise nepermjet nje lidhjeje local loop te nje pale te trete qe do te ofrohet nga Cogent ne emer te Klientit. Si e tille, Klienti dhe Cogent bien dakort se tarifat e percaktuara ne Formularin e Porosise per kete Sherbim presupozojne se ky Sherbim do te perfundoje ne nje pike lidhje te paracaktuar ose ne piken minimale te hyrjes (MPOE) ne ndertesen ku gjendet Vendndodhja e Klientit, siç eshte percaktuar nga ofruesi lokale i aksesit. Cogent mund ti ngarkoje Klientit pagesa shtese jo te perseritura qe nuk jane parashikuar ndryshe ne kete marreveshje per kete Sherbim ku Klienti ose ofruesi lokal i aksesit vendosin qe kjo eshte e nevojshme per te zgjatur piken e lidhjes ose MPOE nepermjet sigurimit te infrastruktures shtese, kabllove, pajisjeve elektronike apo materialeve te tjera te nevojshme per te arritur deri ne Vendndodhjen e Klientit. Do te jete ne pergjegjesine e Klientit te lejoje aksesin ne objekt per ofruesit lokale te aksesit, si dhe per te lehtesuar dhe koordinuar me pronarin e prones ne Vendndodhjen e Klientit, te gjitha hapesirat shtese dhe energjine elektrike qe percaktohen nga ofruesi lokal i aksesit si te nevojshme per te siguruar Sherbimin. Cogent do te njoftoje Klientin per çdo pagese shtese jo te perseritur, nese ka, sa me shpejt te jete e mundur pasi Cogent te jete njoftuar nga ofruesi lokal i aksesit per shumen e pagesave te tilla. Here pas here, Cogent mund te ofroje, dhe Klienti mund te pranoje, vleresime financiare per zgjatjen e pikes se lidhjes ne Vendndodhjen e Klientit se bashku me Formularin e Porosise. Keto kosto te parashikuara mund te bazohen ne disa kosto te njohura ose instalime tipike qe nuk kerkojne perpjekje te jashtezakonshme nga ofruesi per te zgjatur sherbimin. Ne rast se kostot aktuale i tejkalojne kostot e parashikuara, Cogent do te njoftoje Klientin sic pershkruhet me siper.

Gjithashtu, pagesat dhe Kohezgjatja e percaktuara ne Formularin e Porosise per Sherbimin presupozojne se ky Sherbim mund te ofrohet nga Cogent nepermjet ofruesit lokal te aksesit i zgjedhur nga Cogent (dhe / ose Klienti) per Kohezgjatjen e caktuar. Ne rast se Cogent nuk eshte ne gjendje te ofroje kete Sherbim nepermjet ofruesit lokal te aksesit te zgjedhur ose ofruesi lokal i zgjedhur i aksesit kerkon nje pagese me te larte apo nje kohezgjatje me te madhe te Sherbimit ne krahasim me ate te percaktuar ne Formularin e Porosise, Cogent ka te drejten, pa marre parasysh nese Cogent e ka pranuar Formularin e Porosise ose jo, per te pezulluar ofrimin e Sherbimit sipas kesaj marreveshje dhe te njoftoje Klientin me shkrim per çdo pagese shtese jo te perseritur, pagese mujore dhe/ose Kohezgjatjen qe mund te zbatohet, ose per te anulluar Sherbimin e percaktuar ne Formularin e Porosise. Pas marrjes se ketij njoftimi, Klienti do te kete pese (5) dite pune afat per te pranuar ose refuzuar keto ndryshime. Nese Klienti nuk i kthen pergjigje Cogent brenda periudhes pese (5) ditore, keto ndryshime do te konsiderohen te refuzuara nga ana e Klientit. Ne rast se Klienti refuzon ndryshimet (qofte ne menyre te shprehur ose nepermjet skadimit te (5) periudhes pese ditore pune), ose ne qofte se Cogent zgjedh te anulloje Sherbimin e porositur nepermjet kesaj marreveshje, ky Sherbimi do te anullohet pa sjelle anullim ose perfundim te detyrimeve per secilen pale.

Rane dakort dhe nenshkruan palet si me poshte:

| **Klienti** | **COGENT ALBANIA SH.P.K.** |
|---|---|
| Nga:_______ | Nga:______ |
| Titulli:_______ | Titulli:_____ |
| Data:_______ | Data:_____ |

## SHTOJCA E PRODUKTIT TE SHERBIMIT – AKSES I DEDIKUAR INTERNETI

Kjo Shtojce e Produktit te Sherbimit (Shtojca) ndryshon Marreveshjen e Abonimit te Klientit (MAK) te lidhur ndermjet Klientit dhe COGENT per Sherbimet e percaktuara ne MAK. Perveç nese percaktohet ndryshe ne kete Shtojce, termat me germa kapitale ose te perkufizuara ne MAK do te kene te njejtin kuptim edhe ne kete Shtojce. Ne rast te ndonje mosperputhshmerie ndermjet ketyre marreveshjeve, prevalenca do te jete si ne vijim: E para, Formulari i Porosise, E dyta, kjo Shtojce, E treta, Termat dhe Kushtet dhe e Katerta, Marreveshja per Nivelin e Sherbimit (MNS).

### 1. Sherbimi dhe Opsionet

Ne perputhje me qellimin e Sherbimit Akses i Dedikuar Internetiti, COGENT transmeton paketen-IP ndermjet Rrjetit te COGENT dhe rrjeteve te lidhura te Klienteve te tij, si dhe gjithashtu kundrejt dhe nga rrjete nderkombetare te Internetit duke perdorur marreveshjet e transmetimit te drejteperdrejte te te dhenave nga COGENT me rrjetet e tjera.

Ne varesi te disponueshmerise se tyre, Klienti mund te zgjedh nje ose me shume opsione te lidhura me Sherbimin, te tilla si ato te listuara ne Formularin e Porosise, ku Klienti bie dakord qe te paguaje tarifat perkatese te listuara ne Formularin e Porosise.

*MultiBGP*: Klienti mund te lidhet me rrjetin e COGENT nepermjet sesioneve te shumefishta te llojit *BGP* tek nje porte te vetme, ku keto sesione *BGP* jane ne vetvete AS te transferuara (ASN Fillestare) dhe AS-te nga palet e treta te perfaqesuara nga Klienti (ASN-te Sekondare). Ne kete rast, Klientit do t'i kerkohet qe t'i dorezoje COGENT nje Leter Autorizimi ("LA") te leshuar nga palet e treta, te cilet kane regjistruar ASN-te Sekondare ne menyre qe te aktivizojne kete Sherbim, dhe te gjitha nderlidhjet, gjate ofrimit te sherbimeve ose operimeve, te lidhura me sesionet BGP te krijuara ndermjet rrjetit te COGENT dhe ASN-ve Sekondare, te cilat do te rregullohen ekskluzivisht dhe vetem ndermjet COGENT dhe Klientit. Fakti qe nje sesion BGP eshte krijuar ndermjet COGENT dhe paleve te tjera te perfaqesuara nga Klienti, nuk perben nje marredhenie kontraktuale ndermjet COGENT dhe ketyre paleve te tjera, kjo nderlidhje rregullohet nga marredheniet kontraktuale te krijuara ndermjet COGENT dhe Klientit. COGENT do te kerkoje pagimin e nje Tarife Mujore shtese per çdo ASN Sekondare te lidhur.

*Grupimi Link (Link Aggregation) (LAG)*: Ne Vendodhje te caktuara te Sherbimeve, Klienti mund te zgjedhe te grupoje Sherbime Etherneti 10 Gigabit ne keto Vendndodhja te Sherbimit ne nje paket Grupimi Link ("Paketa-LAG"). Ne perputhje me kete opsion, COGENT do te konfiguroje Paketen-LAG ne nje menyre te tille qe, ne rast te nje nderprerje te disa sherbimeve (por jo te gjithave) te perfshira ne Paketen-LAG, Sherbimet e paprekura ne kete Pakete-LAG do te vazhdojne te kalojne

ne trafik. Grupimi Link eshte kombinimi teknik i porteve dhe eshte i pavarur nga sistemi i faturimit: COGENT do te faturoje Sherbimet ne varesi te perdorimit (*burstable*) te perfshira ne Paketen-LAG te pavarura nga njera-tjetra, me perjashtim te rasteve kur Klienti zgjedh ti bashkoje ato duke perdorur opsionet "*Faturimin Total Burst*" ose "*Faturimin i Mbledhur Burst*" te perkufizuara ne nenin 2 me poshte.

*Pajisje*: COGENT mund, sipas gjykimit te vet dhe nese eshte e mundur, te siguroje pajisje per Sherbime te caktuara. Tarifat per keto pajisje sic eshte rene dakord ne Formularin e Porosise do ti shtohen fatures se Klientit. COGENT nuk garanton dhe nuk eshte pergjegjes qe ndonje lloj i veçante pajisjeje, ose çfaredo pajisje, te vihet ne dispozicion te Klientit; dhe keto pajisje do te kalojne ne pronesi te Klientit pas marrjes se tyre. Klienti do te jape mbeshtetjen e tij teknike per instalimin, ruajtjen, dhe integrimin e pajisjeve. COGENT nuk do te siguroje mbeshtetje teknike ne vendndodhje. Klienti do te jete pergjegjes per shpenzimet e zevendesimit te pajisjes sipas rastit nese pajisja ne fjale eshte objekt i ndonje demi, ndryshimi/modifikimi/riparimi te paautorizuar, perdorimi te pertej qellimit te pajisjes, keqperdorimi, neglizhimi ne perdorim, abuzimi, aksidenit, instalimi te papershtatshem, apo akteve te tjera te shkaktuara nga Klienti, punonjesit dhe kontraktoret e tij, ose ndonje person tjeter. Nje veprim ose mosveprim i tille mund beje te pavlefshem çdo garanci dhene nga prodhuesi. Klienti gjithashtu bie dakord te demshperbleje dhe te mbaje te pademtuar COGENT kundrejt cdo pretendimi te pales se trete bazuar ne ndryshime apo modifikime te paautorizuara te pajisjes nga ana e Klientit. COGENT nuk eshte pergjegjes per nderprerjet e Sherbimit te shkaktuara nga ndonje kerkese e Klientit per ndryshimin e vendodhjes se pajisjeve.

*Ofrimi i Pershpejtuar*: Garancia e instalimit te COGENT eshte e rigorozisht e kufizuar nga garancia e instalimit e parashikuar ne MNS. Megjithate, Klienti mund te kerkoje ne Formularin e Porosise, nje ofrim te pershpejtuar te Sherbimit. COGENT do te ndermarre perpjekje te arsyeshme tregtare per te mundesuar kerkesen e Klientit; me kusht, qe COGENT nuk do te garantoje permbushjen e nje kerkese te tille (dhe çdo garanci e tilla e dhene me goje ose me shkrim konsiderohet nepermjet kesaj marreveshje si e refuzuar) si dhe COGENT nuk do garantoje qe Sherbimi do te ofrohet ne nje date te caktuar, si p.sh. Data e Kerkuar e Sherbimit e percaktuar ne Formularin e Porosise.

**2. Sherbimi Burstable**

Nese Klienti blen Sherbimin ne baze te nivelit te perdorimit (Sherbimi Burstable) te COGENT, Klienti do te kete nje angazhim minimal te gjeresise se bandes (bandwidth) te percaktuar per nje port te dhene (Angazhimi Bandwidth apo Norma e Angazhimi te te Dhenave "**NAD**"). Angazhimi Bandwidth per te cilin eshte rene dakord ne Formularin e Porosise dhe perben sasine minimale te

bandwith qe do ti faturohet Klientit çdo muaj, per çmimin e Sherbimit baze, edhe nese nuk eshte perdorur plotesisht nga Klienti gjate nje muaji te caktuar. Klienti mund te kerkoj rritjen e bandwith ne nivelin maksimal qe mund te kryhet nga nje port e caktuar, p.sh. 1,000 Mbps *per nje port Gig-Ethernet,* kjo e limituar nga disponueshmeria e bandwith brenda rrjetit COGENT.

Nese Klienti e tejkalon Angazhimin Bandwidth ne ndonje prej portave Burstable ne çdo muaj kalendarik te dhene, Klienti pranon te paguaje detyrimin shtese per cdo Mbps me teper te perdorur mbi kufirin e percaktuar te Angazhimit Bandwidth siç tregohet ne Formularin e Porosise. Ky perdorim mbi kufirin e percaktuar te Bandwidth llogaritet nga COGENT si diferenca midis perdorimit total te Bandwidth dhe Angazhimit Bandwidth, ku perdorimi total i Bandwidth percaktohet nga mbledhja ne çdo 5 minuta e mostrave te perdorimit te bandwidth gjate gjithe muajit per çdo port (nje moster e tille bazohet ne perdorimin mesatar pergjate nje segmenti prej 5-minutash) dhe percakton perqindjen e sakte (90 ose 95%) te perdorimit siç tregohet ne Formularin e Porosise. Do te mblidhet vetem nje moster e vetme pergjate nje periudhe kohore prej 5-minutash, edhe pse faktikisht mblidhen dy mostra - nje per shfrytezim te brendshem dhe nje per shfrytezim te jashtem. Mostra me vleren me larte do te merret ne konsiderate. Per periudha mujore te pjesshme, do te perdoret numri total i mostrave per muajin kalendarik; per mostrat ku nuk ka perdorimi, 0 eshte vlera e njohur. Per shembull, ne nje periudhe 30-ditore faturimi, jane mbledhur 8,640 mostra (12 mostra/ ore x 24 ore/ dite x 30 dite) dhe jane te renditura nga mostra me vleren me te larte deri tek ajo me e ulet. Ne rastin e nje faturimi ne vleren 95%, vlera me e larte midis 5% ose 432 mostrave nuk merret parasysh (qe perfaqeson 5% me te larte te niveleve te perdorimit). Mostra me e lart e mbetur (p.sh. mostra 433) perdoret per te percaktuar perdorimin total te bandwidth. Ne rastin e nje faturimi ne vleren 90%, vlera me e larte midis 10% ose 864 mostrave nuk merret parasysh (qe perfaqeson 10% me te larte te niveleve te perdorimit).Mostra me e larte e mbetur (p.sh. mostra 865) perdoret per te percaktuar perdorimin total te bandwidth.

Ne perputhje me opsionin e disponueshem "Faturimi Total Burst" ne lidhje me 90% te faturimit burst, COGENT llogarit perdorimin mbi kufirin e percaktuar si diferencen ndermjet sasise totale te perdorimit bandwidth dhe sasise se Angazhimit Bandwidth, mbi totalin e te gjithe portave. Per shembull, ne qofte se Totali i Faturimit Burst zbatohet mbi tre porta me nje Angazhim Bandwidth prej 200 Mbps secila (dmth., nje Angazhimi total Bandwidth prej 600 Mbps) dhe ku sasia totale e perdorimit individual te Bandwidth prej 90% ishte 70 Mbps, 150 Mbps dhe 500 Mbps, perdorimi mbi kufirin e percaktuar Bandwidth do te jete 120 Mbps (70 + 150 + 500-600).

Ne perputhje me opsionin e disponueshem "Faturimi i Mbledhur Burst" ne lidhje me 95% te faturimit burst, perdorimi mbi kufirin e percaktuar te Bandwidth llogaritet nga COGENT si diferenca midis totalit te mbledhur te perdorimit te Bandwidth dhe totalit te Angazhimit te Bandwidth mbi te gjitha portat e mbledhura, ku totali i perdorimit te Bandwidth percaktohet duke

shtuar mostra perdorimi çdo 5 minuta mbi te gjitha portat e mbledhura. Per shembull, ne qofte se ka tre porte te mbledhura, çdo 5 minuta tre mostra te brendshme dhe tre mostra te jashtme mblidhen, dhe i shtohen nje vlere te perdorimit te Bandwidth per drejtim, dhe vlera me e larte ne mes tyre do te merret ne konsiderate. Ne nje periudhe faturimi 30-ditore, vlerat perdundimtare e konsideruar 8,640 e perdorimit Bandwidth pasqyron perdorimin e mbledhur mbi te gjitha portet. Keto vlera jane te renditura nga vlera me e larte tek ajo me e ulet. Vlera me e larte midis 5% ose 432 nuk merret parasysh (qe perfaqeson 5% me te larte te niveleve te perdorimit). Vlera me e larte e mbetur (p.sh. vlera 433) eshte perdorur per te percaktuar totalin e mbledhur te perdorimit bandwidth.

Ne perputhje me te dyja opsionet "Faturimi Total Burst" dhe "Faturim i Mbledhur Burst", parashikohet nje Sherbim Master ne Formularin e Porosise, ku te gjitha Sherbimet e tjera te perfshira ne Totalin apo Mbledhjen e llogaritur jane te listuara. Perdorimi mbi kufrin e percaktuar te Bandwidth (perdorimi Burst) qe llogaritet ne te gjithe portat e listuara, do te faturohet ne baze te percaktimeve te Sherbimit Master. Te dhenat perkatese (shtese mbi pagesen per perdorimin e Mbps mbi kufirin e percaktuar te Bandwidth dhe Monedha e Faturimit) qe i perkasin Sherbimit Master, do te perdoren per te llogaritur tarifat shtese te perdorimit mbi kufirin e percaktuar te Bandwidth mbi Sherbimit Master dhe mbi te gjitha sherbimet e tjera te perfshira. Per shembull, ne qofte se nje klienti urdheron porta ne Britanin e Madhe, SHBA dhe Kanada, dhe percakton porten e SHBA si Master, i gjithe perdorimin mbi kufirin e percaktuar Bandwidth do te faturohet ne faturen e SHBA ne Dollare Amerikane (USD), ne tarifen burst te treguar ne formularin e porosise ne SHBA.

Keto opsione faturimi jane te pavarura nga opsioni i Grupimit Link (LAG): COGENT nuk do te kombinoje Sherbimet e perfshira ne "Faturimin Total Burst" ose "Faturimin e Mbledhur Burst" ne nje Pakete-LAG, me perjashtim te rasteve kur Klienti vendos per ti kombinuar ato duke perdorur opsionin e Grupimit Link (LAG), te perkufizuar ne nenin 1 me siper. Per me teper, ne qofte se Klienti deshiron qe COGENT te faturoje Sherbime si pjese e nje Paketes-LAG sipas opsionit "Faturimi Total Burst" ose "Faturimi i Mbledhur Burst", atehere Klienti duhet te zgjedhe keto opsione per keto Sherbime, perveç zgjedhjes se opsionit LAG.

**3. Detyrimi i Klientit per Bashkepunim**

Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te bashkepunoje me Cogent ne procesin e instalimit, proces i cili perfshin permbushje e sakte te nje Formulari Porosie qe permban informacion te detajuar per lidhjen (demarcation) dhe listimin e kontakteve te tjera ne vendndodhje, dhe te pyetesoreve te nevojshem teknik (Pyetesori IP, Pyetesori BGP,etj) te dhene nga Cogent. Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te jene fizikisht te pranishem ne momentin e instalimit. Gjate instalimit dhe ne cdo kohe

tjeter, Klienti do te lejoje aksesin dhe nese eshte e nevojshme te siguroje shoqerimin, per Cogent ose perfaqesuesit e saj, personelin e nevojshem per te kryer instalimin dhe mirembajtjen e Sherbimit, ne kasen(at) telefonike te percaktura ne ndertese ose dhomat e telekomunikacionit ose ne ambjentet e Klientit me qellim kontrollin, instalimin, funksionimin dhe mirembajtjen e Sherbimit, pas nje marreveshje paraprake midis paleve. Mosbashkepunimi i Klientit do te shkarkoje Cogent nga detyrimet e saj ne lidhje me Garancine e Instalimit qe ben pjese ne MNS, por nuk do te nderprese Daten e Sherbimit ose daten e fillimit te faturimit.
Ne rastin e problemeve teknike te lidhura me Sherbimin, Klienti do te siguroje qe inxhinieret e sherbimit te Cogent ose perfaqesuesit e tij te kene nje akses te pakufizuar ne kasen(at) telefonike te caktura ne ndertese ose dhomave te telekomunikacionit ose ne pajisjet e ndodhura ne ambjentet e Klientit. Mossigurimi i aksesit nga ana e Klientit, do te shkarkoje Cogent nga detyrimet e tij ne perputhje me Disponueshmerine e Rrjetit, si pjese e MNS.

**4. Pika e Lidhjes**

*Ne Qendren e te dhenave te Cogent*: Nese ofrimi i Sherbimit kryhet brenda nje qendre te dhenash te Cogent, shoqeria Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje pike lidhjeje qe ndodhet ne pajisjet Cogent. Cogent do te siguroje, ruaje dhe operoje lidhjen e nevojshme ("Cross-Connect") per Klientin per t'u lidhur me sherbimin e Cogent ne piken e caktuar te lidhjes. Cogent do te siguroje kete lidhje Cross-Connect kundrejt tarifave sic tregohet ne Formularin e Porosise.

*Ne nje qender te dhenash te nje pale te trete*: Nese ofrimi i Sherbimit kryhet brenda nje qendre te dhenash te nje pale te trete (psh. qe nuk eshte ne zoterim dhe/ose operim nga Cogent), shoqeria Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje Pike Lidhjeje te vendosur ne pajisjet e Cogent. Pervec nese eshte rene dakort ndryshe, Klienti me shpenzimet e veta do te siguroje, ruaj dhe operoj lidhjen e nevojshme ("Cross-Connect") per t'u lidhur sherbimin e Cogent me piken e caktuar te lidhjes. Nese Klienti dhe Cogent bien dakort qe Cogent do te ofroje kete lidhje, atehere Cogent do te ofroj kete lidhje perkundrejt tarifave ashtu sic tregohet ne Formularin e Porosise dhe pika e lidhjes se Sherbimit do te qendroje ne pajisjet e Cogent.

*Ne nje ndertese te nje shoqerie On-Net:* Nese ofrimi i Sherbimit kryhet On-Net brenda nje ndertese te nje shoqerie, Cogent do te ofroje Sherbimin ne nje pike lidhjeje te pozicionuar ne pajisjet e Cogent ne ambjentet e Klientit. Cogent do te siguroje, mbaje dhe operoje lidhjen e nevojshme ("Riser") ndermjet hyrjes ne ndertese dhe pikes se caktuar te lidhjes.

*Ne nje Vendndodhje te Klientit Off-Net*: Sherbimet Off-Net do te ofrohen ne Vendndodhjen e Klientit sic tregohet ne Formularin e Porosise nepermjet nje lidhjeje local loop te nje pale te trete qe do te ofrohet nga Cogent ne emer te Klientit. Si e tille, Klienti dhe Cogent bien dakort se tarifat

e percaktuara ne Formularin e Porosise per kete Sherbim presupozojne se ky Sherbim do te perfundoje ne nje pike lidhje te paracaktuar ose ne piken minimale te hyrjes (MPOE) ne ndertesen ku gjendet Vendndodhja e Klientit, siç eshte percaktuar nga ofruesi lokale i aksesit. Cogent mund ti ngarkoje Klientit pagesa shtese jo te perseritura qe nuk jane parashikuar ndryshe ne kete marreveshje per kete Sherbim ku Klienti ose ofruesi lokal i aksesit vendosin qe kjo eshte e nevojshme per te zgjatur piken e lidhjes ose MPOE nepermjet sigurimit te infrastruktures shtese, kabllove, pajisjeve elektronike apo materialeve te tjera te nevojshme per te arritur deri ne Vendndodhjen e Klientit. Do te jete ne pergjegjesine e Klientit te lejoje aksesin ne objekt per ofruesit lokale te aksesit, si dhe per te lehtesuar dhe koordinuar me pronarin e prones ne Vendndodhjen e Klientit, te gjitha hapesirat shtese dhe energjine elektrike qe percaktohen nga ofruesi lokal i aksesit si te nevojshme per te siguruar Sherbimin. Cogent do te njoftoje Klientin per çdo pagese shtese jo te perseritur, nese ka, sa me shpejt te jete e mundur pasi Cogent te jete njoftuar nga ofruesi lokal i aksesit per shumen e pagesave te tilla. Here pas here, Cogent mund te ofroje, dhe Klienti mund te pranoje, vleresime financiare per zgjatjen e pikes se lidhjes ne Vendndodhjen e Klientit se bashku me Formularin e Porosise. Keto kosto te parashikuara mund te bazohen ne disa kosto te njohura ose instalime tipike qe nuk kerkojne perpjekje te jashtezakonshme nga ofruesi per te zgjatur sherbimin. Ne rast se kostot aktuale i tejkalojne kostot e parashikuara, Cogent do te njoftoje Klientin sic pershkruhet me siper.

Gjithashtu, pagesat dhe Kohezgjatja e percaktuara ne Formularin e Porosise per Sherbimin presupozojne se ky Sherbim mund te ofrohet nga Cogent nepermjet ofruesit lokal te aksesit i zgjedhur nga Cogent (dhe / ose Klienti) per Kohezgjatjen e caktuar. Ne rast se Cogent nuk eshte ne gjendje te ofroje kete Sherbim nepermjet ofruesit lokal te aksesit te zgjedhur ose ofruesi lokal i zgjedhur i aksesit kerkon nje pagese me te larte apo nje kohezgjatje me te madhe te Sherbimit ne krahasim me ate te percaktuar ne Formularin e Porosise, Cogent ka te drejten, pa marre parasysh nese Cogent e ka pranuar Formularin e Porosise ose jo, per te pezulluar ofrimin e Sherbimit sipas kesaj marreveshje dhe te njoftoje Klientin me shkrim per çdo pagese shtese jo te perseritur, pagese mujore dhe/ose Kohezgjatjen qe mund te zbatohet, ose per te anulluar Sherbimin e percaktuar ne Formularin e Porosise. Pas marrjes se ketij njoftimi, Klienti do te kete pese (5) dite pune afat per te pranuar ose refuzuar keto ndryshime. Nese Klienti nuk i kthen pergjigje Cogent brenda periudhes pese (5) ditore, keto ndryshime do te konsiderohen te refuzuara nga ana e Klientit. Ne rast se Klienti refuzon ndryshimet (qofte ne menyre te shprehur ose nepermjet skadimit te (5) periudhes pese ditore pune), ose ne qofte se Cogent zgjedh te anulloje Sherbimin e porositur nepermjet kesaj marreveshje, ky Sherbimi do te anullohet pa sjelle anullim ose perfundim te detyrimeve per secilen pale.

Rane dakort dhe nenshkruan palet si me poshte:

| | |
|---|---|
| Klienti | COGENT ALBANIA SH.P.K. |
| Nga:________ | Nga:_____ |
| Titulli:_______ | Titulli:_____ |
| Data:_______ | Data:_____ |

## SHERBIMET E RRJETIT - MARREVESHJA E NIVELIT TE SHERBIMIT

Kjo Marreveshje e Nivelit te Sherbimit (MNS) eshte pjese e marreveshjes se abonimit te klientit (MAK ose Marreveshja) e lidhur midis Klientit dhe Cogent. Termat me shkronja te medha te perdorura ne kete marreveshje dhe qe nuk jane te perkufizuara ketu do te kene te te njejtin kuptim qe i jepet atyre ne MAK.

### 1. ANGAZHIMI PER SHERBIM

Cogent eshte i angazhuar per te siguruar nje rrjet te besueshem dhe me cilesi te larte per te mbeshtetur sherbimet me shpejtesi te larte ne rrjetin e tij (Sherbimi). Si pjese e ketij angazhimi, Cogent ka kenaqesine ti ofroje Klienteve te tij garancite e meposhtme qe kane te bejne me Sherbimin ne Ameriken e Veriut, Evrope dhe Azi:

- Garancia e Instalimit
- Disponueshmeria e Rrjetit dhe Garancia e Njoftimit
- Garancia e Shpejtesise se Rrjetit (Network Latency Guarantee)
- Garancia e Shperndarjes se Paketes

**Sherbimet per Klientet "Off-Net Baze" Ethernet Point to Point nuk gezojne ndonje prej garancive te treguara ne MNS. Garancia e Njoftimit, Garancia e Shpejtesise dhe Garancia e Sherndarjes se Paketes zbatohen vetem per Klientet e Cogent per Sherbimet me Akses te Dedikuar Interneti**. Nese Cogent nuk permbush ndonje nga keto garanci, ai do ti ofroje Klienteve nje Kredit Sherbimi (Service Credit) siç percaktohet me poshte ne kete Marreveshje te Nivelit te Sherbimit.

### 2. GARANCITE

### A. GARANCIA E INSTALIMIT

Per cdo Sherbim te listuar me poshte, Cogent garanton qe lidhja me Klientet do te instalohet brenda afatit kohor perkates, te matur nga data kur nje porosi eshte bere e vlefshme dhe eshte futur ne sistemin e ofrimit te sherbimit te Cogent nga ekipi i tij i Kordinimit te Llogarise.

- On-Net: 17 dite pune
- T1 / El: 40 dite pune

- T3 / E3: 60 dite pune
- Colo: 17 dite pune
- Ocx/ STMx: 90 dite pune
- Ethernet Loop: 90 dite pune

Nje porosi nuk do te behet e vlefshme pa nje Formular Porosie dhe MAK te nenshkruar dhe cdo dokument tjeter i kerkuar nga Cogent, te jete marre, vleresuar dhe futur ne sistemin e ofrimit te sherbimit te Cogent nga ekipi i Kordinimit te Llogarise. Dokumentacioni shtese i kerkuar mund te perfshije nje aplikim te perfunduar te kreditit dhe nje plotesim te pyetesorit per Transferimi te IP si dhe pyetesore te plotesuar per konfigurimet BGP, SMTP dhe DNS kur kerkohen nga Klienti ne Pyetesorin e Transferimit te IP.

Garancia e Instalimit te Cogent per Sherbimet e ruajtjes se te dhenave (colocation services) nuk aplikohet per qendra te dhenash te paleve te treta. Per lidhjet Ethernet Point to Point, porta me kohen e instalimit me te gjate do te prevaloj te gjithe porosine, p.sh. ne qofte se nje porte eshte On-Net dhe porta tjeter kerkon nje Ethernet Loop, koha me e gjate e instalimit qe i korespondon Ethernet Loop do te aplikohet per te dyja porosite.

Ne se Cogent nuk permbush keto angazhime, Klienti do te marre, me kerkesen e Klientit, nje (1) muaj Kredit Sherbimi. Klienti mund te perfitoje jo me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene. Garancia e Instalimit te Cogent i nenshtrohet kushteve te meposhtme:

- Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te bashkepunoje me Cogent ne procesin e instalimit, i cili perfshin plotesimin e sakte te nje Formulari Porosie i cili permban informacion te detajuar te lidhjes dhe listimin e kontakteve ne vendndodhje. Ndryshimet ne nje Formular Porosie te bera nga ose ne emer te Klientit ose ndodhja e ngjarjeve jashte sferes se kontrollit te arsyeshem nga ana e Cogent, si psh Forca Madhore (sic percaktohet ne MAK), mund te cojne ne vonesa per te cilat Cogent nuk mban pergjegjesi sipas kesaj marreveshjeje.

- Klienti ose perfaqesuesi i tij duhet te jete i pranishem fizikisht ne kohen e instalimit dhe duhet te ofroje akses ne kasen(at) telefonike te percaktura te nderteses ne daten(at) per te cilat eshte renen dakort me Departamentin e Koordinimit te Instalimit te Cogent. Ky akses dhe shoqerim ne ndertese duhet gjithashtu ti sigurohet edhe personelit te nevojshem per kryerjen e instalimit te lidhjes.

- Garancia e Instalimit aplikohet ne intervalin midis dates fillestare te porosise dhe dates fillestare te Garancise se Instalimit. Nese Klienti kerkon ndryshim te dates se porosise

gjate zbatimit te Sherbimit, data e Garancise se Instalimit, ne diskrecionin e vetem te Cogent, do te filloje perseri me pranimin e ndryshimeve.

- Kredit Sherbimi per mospermbushje te Garancise se Instalimit nuk eshte i aplikueshem per Klientet per te cilet eshte hequr dore nga ose eshte ulur tarifa e instalimit.

## B. DISPONUESHMERIA E RRJETIT DHE GARANCIA E NJOFTIMIT

Rrjeti i Cogent eshte projektuar per 100% disponueshmeri.

Sherbimi On-Net. Ne qofte se Klienti ka nje Nderprerje Rrjeti te nje Sherbimi On-Net per me shume se 15 minuta pa nderprerje, Klienti do te marre me ane te nje kerkese, nje (1) dite Kredit Sherbimi per cdo ore te shtuar nga Nderprerja e Rrjetit ne çdo muaj kalendarik. Me kusht qe Rrjeti i Cogent te kaloje te pakten nje (1) ore Nderprerje Rrjeti per ndonje muaj kalendarik te dhene, Nderprerja shtese e Rrjetit ne me pak se nje (1) ore do te coje ne nje Kredit Sherbimi propocional. (Shembull: 2 ore, 15 minuta nderprerje te rrjetit nenkupton 2.25 dite Kredit Sherbimi). Klienti, mund te perfitoje jo me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene.

Sherbimi Off-Net. Ne qofte se Klienti ka nje Nderprerje Rrjeti te nje Sherbimi Off-Net per me shume se 15 minuta pa nderprerje, Klienti do te marre ane te nje kerkese nje (1) ore Kredit Sherbimi per cdo ore te shtuar nga Nderprerja e Rrjetit ne kete muaj kalendarik. Me kusht qe Rrjeti i Cogent te kaloje te pakten dy (2) ore Nderprerje Rrjeti per ndonje muaj kalendarik te dhene, Nderprerja shtese e Rrjetit ne me pak se nje (1) ore do te coje ne nje Kredit Sherbimi porporcional. (Shembull: 2 ore, 15 minuta nderprerje te rrjetit nenkupton 2.25 ore Kredit Sherbimi). Klienti, nuk mund te perfitoje me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene.

Garancia e Njoftimit te Pushimit te COGENT eshte te njoftoje ne menyre paraprake nje Klient me Akses te Dedikuar Interneti brenda 15 minutave pasi COGENT percakton qe Sherbimi i Klientit eshte i padisponueshem. Procedura standarte e Cogent eshte te testoje ruterin (ping router) cdo minute. Nese Ruteri i Klientit nuk pergjigjet pas dhjete cikleve te testimit te njepasnjeshme, COGENT do e konsideroje Sherbimin e padisponueshem dhe do te kontaktoje piken e percaktuar te kontaktit te Klientit me nje nga menyrat e zgjedhura prej COGENT (telefon, email, fax, ose pager).

Ne qofte se COGENT nuk arrin te permbushe kete Garanci Njoftimi te Pushimit, Klienti do te marre me ane te nje kerkese nje (1) dite Kredit Sherbimi per Sherbimin qe kjo Garanci nuk eshte permbushur. Klienti mund te marre jo me shume se nje dite Kredit Sherbimi per cdo dite,

pavaresisht sa here Cogent nuk ka permbushur gjate asaj dite Garancine e Raportimit te Klientit. Klienti nuk mund te perfitoje me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene.

Ne qofte se nje Klient me Akses te Dedikuar Interneti zgjedh te grumbulloje disa Sherbime duke perdorur opsionin e Grumbullimit te Link-eve (LAG), atehere kjo pakete LAG do te konsiderohet se perfaqeson nje Sherbim te vetem per qellime te Disponueshmerise se Rrjetit dhe Garancise se Njoftimit te Pushimit. Rrjedhimisht, Klienti do te kete te drejten te marre Kredit Sherbimi sipas seksionit 2B, vetem ne qofte se Klienti ka Nderprerje ne Rrjet per te gjitha Sherbimet e grumbulluara ne paketen LAG. Nderprerja e cdo nengrupi te vecante te Sherbimit te grumbulluar ne paketen LAG nuk do te perbeje Nderprerje Rrjeti dhe Klienti nuk do te kete te drejte per ndonje Kredit Sherbimi ne lidhje me kete nderprerje. Klienti mund te zgjedhe te heq dore, nepermjet konfigurimit administrativ, nga e tere paketa LAG nese ndonje Sherbim i vecante i perfshire ne paketen LAG behet i padisponueshem; megjithate, kjo nuk do te perbeje Nderprerje te Rrjetit, me perjashtim te rasteve kur te gjitha Sherbimet qe bejne pjese ne paketen LAG kane Nderprerje Rrjeti.

**C. GARANCIA E SHPEJTESISE SE RRJETIT**

Vetem per Klientet me Akses te Dedikuar Interneti, Shpejtesia (Latency) mesatare mujore e Rrjetit per paktetat e ofruara nga Rrjeti COGENT nepermjet Backbone Hubs per rajonet e meposhtme do te jete si me poshte:

| | |
|---|---|
| Ne Ameriken e Veriut: | 45 milisekonda ose me pak |
| Ne Europe: | 35 milisekonda ose me pak |
| New York - Londer (transatlantic): | 85 milisekonda ose me pak |
| Los Angeles - Tokio (transpacific): | 120 milisekonda ose me pak |

Shpejtesia e Rrjetit (ose Koha e Ciklit te Plote) perkufizohet si koha mesatare qe i duhet nje pakete IP per te bere nje cikel te plote (vajte-ardhje) ndermejt Backbone Hubs brenda rajoneve te specifikuara me larte ne Rrjetin e COGENT. COGENT monitoron shpejtesin mesatare brenda Rrjetit COGENT duke monitoruar vazhdimisht kohen e cikleve ndermjet nje mostre Backbone Hubs.

Pas njoftimit nga Klienti per crregullime te normave te Shpejtesise se Rrjetit te specifikuara me larte, COGENT do te ndermarre perpjekjet e arsyeshme tregtare per te percaktuar prejardhjen e

nje crregullim te tille te Shpejtesise se Rrjetit dhe do te riparoje nje crregullim te tille per sa kohe qe burimi i defektit rrjedh nga Rrjeti i COGENT.

Nese COGENT deshton te riparoje nje crregullim te tille te Shpejtesise se Rrjetit brenda dy (2) oreve nga njoftimi i ndonje crregullimi te tepruar te Shpejtesise se Rrjetit, dhe kur Shpejtesia mesatare e Rrjetit per 30 ditet e meparshme i ka tejkaluar normat e percaktuara me lart, Klienti do te marre me ane te nje kerkese nje Kredit Sherbimi per periudhen nga njoftimi i Klientit deri ne momentin qe Shpejtesia mesatare e Rrjetit per 30 ditet e meparshme eshte me pak se normat e percaktuara me lart. Klienti nuk mund te marre me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene.

**D. GARANCIA E TRANSMETIMIT TE PAKETES**

Vetem per Klientet me Akses te Dedikuar Interneti, Rrjeti Cogent ka nje Humbje mesatare mujore ne Pakete jo me shume se 0.1% (ndryshe transmetim te paketes me sukses ne masen 99,9%). Humbja ne Pakete perkufizohet si perqindja e paketave qe humbasin ndermjet Backbone Hubs ne Rrjetin COGENT. COGENT monitoron kete humbje teresore ne pakete ne menyre te vazhdueshme, dhe mbledh te dhenat e grumbulluara ne nje matje mujore mesatare te humbjes ne pakete per Rrjetin COGENT.

Pas njoftimit nga Klienti per Humbje ne Pakete ne nje mase me te madhe se 0.1%, COGENT do te nderrmarre perpjekje te arsyeshme tregtare per te percaktuar burimin e nje Humbje te tille ne Pakete dhe per te riparuar nje defekt te tille per sa kohe qe burimi i defektit vjen nga Rrjeti i COGENT.

Nese COGENT deshton te riparoje nje Humbje te tille ne Pakete brenda dy (2) oreve nga njoftimi per ndonje Humbje te tepruar ne Pakete ne Rrjetin e COGENT, dhe kur Humbja mesatare e Rrjetit per 30 ditet e meparshme e ka tejkaluar masen prej 0.1%, Klienti do te marre me ane te nje kerkese nje Kredit Sherbimi per periudhen nga njoftimi i Klientit deri ne momentin qe Humbja Mesatare ne Pakete per 30 ditet e meparshme eshte me pak se 0.1%. Klienti nuk mund te marre me shume se nje (1) muaj Kredit Sherbimi per cdo muaj te dhene.

**3. PERKUFIZIME SHTESE**

Akses i Dedikuar Interneti ose Internet Tranzit nenkupton Nivelin 3 te Sherbimit te COGENT, e cila i ofron Klienteve akses ne internet publik.

Backbone Hub nenkupton nje strukture te madhe te rrjetit e zoteruar, operuar, ose e kontrolluar nga COGENT, e cila eshte e lidhur drejtperdrejt me rrjetin e fibrave backbone te COGENT dhe e cila permban te pakten nje ruter qendror. Ne tregjet e medha urbane qe permbajne me shume se nje strukture te tille, nje nder keto struktura ne kete treg do te percaktohet si nje Backbone Hub me qellim llogaritjen mesatare mujore te Shpejtesise se Rrjetit dhe statistikave te Humbjes ne Pakete.

Off-Net nenkupton ndertesat qe jane te lidhura direkt me Rrjetin e Cogent duke perdorur struktura dhe sherbime te tjera transmetimi per te siguruar lidhjen last mile nga Vendodhja e Sherbimit tek Rrjeti i COGENT.

On-Net nenkupton ndertesat qe jane te lidhura direkt me Rrjetin COGENT dhe, si te tilla, nuk kerkojne qe COGENT te marre me qira ndonje pale te trete local loop per te siguruar lidhjen.

Rrjeti COGENT nenkupton Rrjetin e transmetimit te te dhenave dhe telekomunikacionit dhe komponenteve te rrjetit te zoteruar, operuar apo kontrolluar nga COGENT, duke perfshire fibrat kombetare backbone, rrjetet e fibrave urbane, çdo pajisje te lidhur me keto fibra, software, te dhena dhe njohuri te perdorur nga COGENT per te ofruar Sherbimet. Ne rastet kur Cogent ofron sherbime per nje ndertese me pajisjet e veta, Rrjeti i Cogent i perfshin edhe keto pajisje. Rrjeti i COGENT nuk perfshin pajisjet ne ambjentet e klientit, rrjetet e telefonise se klientit, dhe çdo rrjet ose pajisje te rrjetit qe nuk operohet dhe kontrollohet nga COGENT.

Pagese Mujore nenkupton tarifen fikse periodike te faturuar nga COGENT per Klientin, ne baza mujore per Sherbimin, pavarsisht tarifave te ndryshueshme ne baze te perdorimit te Klienteve. Ne rast te sherbimeve te grumbulluara qe perdorin opsionin e Grupimit Link (LAG), atehere Pagese Mujore e kesaj pakete-LAG nenkupton shumen e Pagesave Mujore te te gjitha sherbimeve te perfshira ne kete pakete-LAG.

Nderprerje Rrjeti nenkupton numrin e minutave qe Rrjeti i COGENT nuk eshte ne dispozicion te Klientit, duke perfshire edhe numrin e minutave qe Rrjeti i COGENT nuk eshte ne dispozicion nga ndonje mirembajtje jo e planifikuar e Rrjetit COGENT. Nderprerja e Rrjetit nuk do te perfshije mirembajtjen e planifikuar, apo ndonje nderprerje qe rezulton nga: (a) probleme me ose mirembajtjen ne aplikacionet, pajisjet ose objektet e Klientit, (b) veprimet ose mosveprimet e Klientit apo nje perdoruesi te autorizuar, (c) nderprerje te shkaktuara nga shoqeri te tjera te ndryshme nga COGENT, perveç local loop te porositura nga Cogent tek pale te treta, ose (d) Forces Madhore.

Mirembajtje e planifikuar nenkupton çdo mirembajtje te Rrjetit COGENT (ose pjese te Rrjetit), ne te cilen eshte lidhur ruteri i Klientit, qe kryhet gjate nje hapsire standarte mirembajtje nga ora

00:00-06:00 am (koha lokale e COGENT Hub ne te cilen eshte lidhur qarku i Klientit). Klienti do te njoftohet nepermjet Email te pakten dy (2) dite pune perpara per ndonje mirembajtje te planifikuar qe mund te ndikoje ne sherbimin e tij. Ne shumicen e rasteve, mirembajtja e kryer nuk do te marre te gjithe hapsiren kohore te percaktuar me larte, megjithate, COGENT do te informoje Klientin me ane te E-mail per kohezgjatjen e parashikuar per mirembajtjen e njoftuar.

Kredit Sherbimi nenkupton:

- Nje dite Kredit Sherbimi = 1/30 te Pagese Mujore te Klientit
- Nje jave Kredit Sherbimi = 7/30 te Pagese Mujore te Klientit
- Nje muaj Kredit Sherbimi = Shumen e Plote te Pageses Mujore te Klientit

Nese Cogent miraton nje pretendim per Kredit Sherbimi per mospermbushjen e Garancise se Instalimit, Kredit Sherbimi do te nenkuptoje Pagesen Mujore te Klientit per muajin e pare te Sherbimit, pa perfshire pagesat e instalimit ose tarifat e tjera fillestare.

## 4. PROCESI I PRETENDIMIT TE KREDIT SHERBIMIT

Ne menyre qe te ngreje nje pretendim per Kredit Sherbimi, Klienti duhet te kontaktoj me grupin e sherbimit te klientin te COGENT brenda shtate (7) diteve pune pas perfundimit te muajit per te cilin kerkohet krediti. Kerkesa per Kredit Sherbimi duhet te permbaje: (a) emrin e Klientit dhe te dhenat e kontaktit, (b) daten dhe oren e fillimit/mbarimit te pushimit apo deshtimit te sherbimit te pretenduar dhe (c) nje pershkrim te shkurter te karakteristikave te pushimit apo deshtimit te sherbimit te pretenduar.

Klienti do te njoftohet me ane te nje e-mail-i per vendimin ne lidhje me kerkesen. Nese kerkesa refuzohet, njoftimi do te specifikoje arsyet e refuzimit. Nese kerkesa miratohet, Cogent do te ofroje Kredit Sherbimi ne llogarine e Klientit, te reflektuar ne faturen e ardhshme. Nuk do te jepen Kredit Sherbime te shumfishta per te njejten periudhe kohore, dmth, deshtimi per te permbushur kriteret e shumfishta gjate nje periudhe kohore gjeneron nje Kredit Sherbimi te vetem. Numri total i te gjithe Kredit Sherbimeve lidhur me te gjitha deshtimet per te permbushur Garancite qe ndodhin ne nje muaj te caktuar, nuk mund te kaloje Pagesen Mujore totale te paguara nga Klienti per Sherbimin gjate atij muaji. Kredit Sherbimi do te kreditohet kundrejt pageses mujore te Klientit per Pagesat Mujore dhe nuk mund te merret ne formen e nje rimbursimi.

Garancite dhe Kredit Sherbimet te parashikuara ne kete MNS, presupozojne pajtueshmerine e Klientit me termat dhe kushtet e MAK te lidhur ndermjet tij dhe COGENT, dhe deshtimi i Klientit te permbushe keto terma dhe kushte mund te beje te pavlefshme garancite e COGENT te ofruara ne

kete marreveshje. Asnje kreditim nuk do ti jepet nje Klienti qe (a) nuk lejon Cogent te monitoroje ruterin ne ambjentet e Klientit; (b) nuk ofron aksesin e nevojshem per personelin dhe ne strukturat ne ambjentet e Klientit per te mundesuar COGENT te kryej ndreqjen e problemeve teknike ne menyre teresore, ose (c) llogaria e te cilit ka detyrime financiare ndaj COGENT. COGENT nuk eshte pergjegjes per deshtimin per te permbushur detyrimet e tij ne perputhje me kete marreveshje, nese nje deshtim i tille shkaktohet nga perdorimi mbi kufirin e percaktuar te gjeresise se bandes (bandwidth) nga ana e Klientit sic tregohet ne MAK, ndonje nderhyrje te Klientet mbi pajisjet, ose veprime pertej kontrollit te arsyeshem te COGENT, te tilla si Forca Madhore.